

VENDIM
Nr.272, datë 5.3.2008

PËR MIRATIMIN E STRATEGJISË SEKTORIALE “PËR ZHVILLIMIN E INFRASTRUKTURËS SË CILËSISË NË SHQIPËRI”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 6 të ligjit nr.9682, datë 6.2.2007 “Për ratifikimin e marrëveshjes së financimit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Shoqatës Ndërkombëtare për Zhvillim (IDA), për projektin “Reforma për përmirësimin e mjedisit të biznesit dhe fuqizimin institucional”, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e strategjisë sektoriale “Për zhvillimin e infrastrukturës së cilësisë në Shqipëri”, sipas dokumentit, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

STRATEGJIA SEKTORIALE
PËR ZHVILLIMIN E INFRASTRUKTURËS SË CILËSISË NË SHQIPËRI

SHKURTIME

ANMI	Instituti i Propozuar Shqiptar i Metrologjisë Kombëtare
ASTM	Shoqata Amerikane për Testim dhe Materiale (www.astm.org)
BIPM	Byroja Nderkombetare e Peshave dhe Masave (www.bipm.org)
OVK	Organi i Vlerësimit të Konformitetit
CGPM	Konferenca e Përgjithshme e Peshave dhe Masave (www.bipm.org)
CE	Marka CE
CEN	Comité Européen de Normalisation (www.cenorm.be)
CENELEC	Comité Européen de Normalisation Electrotechnique (www.cenelec.org)
CRM	Materiali i Certifikuar i Referimit
DA	Drejtoria e Përgjithshme për Akreditimin
DMSHI	Drejtoria e Metrologjisë Shkencore dhe Industriale e DPMK
DLM	Drejtoria e Metrologjisë Ligjore e DPMK
DSM	Drejtoria e Mbiqyrjes së Tregut
DPMK	Përdorur gjithashtu për DPM.
DPS	Drejtoria e Përgjithshme e Standardizimit
DSM	Drejtoria e Supervizionit Metrologjik e DPMK
EA	Bashkëpunimi European për Akreditim (www.european-accreditation.org)
EN	Standardi European
EOTC	Organizata Europiane për Vlerësimin e Pajtueshmërisë (www.eotc.be)
ETSI	Instituti i Standardeve të Telekomunikacionit European (www.etsi.org)
EU	Bashkimi European
EUROLAB	Federata Europiane e Shoqatave Kombëtare të Matjeve, Testimit dhe Laboratoreve Analitike
EUROMET	Bashkëpunimi European në Standardet e Matjeve (www.euromet.org)
EURACHEM	Fokus për Kiminë Analitike në Europë (www.eurachem.ul.pt)
DPMK	Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë dhe Kalibrimit (gjithashtu DPM)
IAF	Forumi Ndërkombëtar i Akreditimit (www.ifa.org)
IEC	Komisioni Ndërkombëtar Elektroteknik (www.iec.ch)
ILAC	Bashkëpunimi i Akreditimit të Laboratorit Ndërkombëtar (www.ilac.org)
IMEKO	Konfederata Ndërkombëtare e Matjeve (www.imeko.org)
ISO	Organizata Ndërkombëtare për Standardizimin (www.iso.ch)
IT	Teknologjia e Informacionit
METE	Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës (e Shqipërisë)

IC	Infrastruktura e Cilesise
OIML	Organizata Nderkombetare e Metrologjise Lijore(www.oiml.org)
PAD	Dokumenti i Vleresimit të Projektit
PCU	Njësia e Koordinimit të Projektit
PIU	Njësia e Zbatimit të Projektit
PT	Testimi i Efektivitetit
ToR	Termet e Referencës
UNDP	Programi i Zhvillimit të Kombeve të Bashkuara
USAID	Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (www.usaid.gov)
WELMEC	Bashkëpunimi Europian në Metrologjinë Lijore (www.welmec.org)
OBT	Organizata Botërore e Tregtisë

TERMINOLOGJIA

Infrastruktura e Cilësisë

Metrologjia, Standardet, Testimi, Cilësia. Infrastruktura bazë në një vend që është e nevojshme për zhvillimin e teknologjisë, prodhimin, shërbimet dhe tregtinë. Standardet janë grupe specifikesh teknike që përdoren si rregulla ose udhëzime për të përshkruar karakteristikat e materialeve, produkteve, shërbimeve ose proceseve. Cilësia arrihet me anë të prodhimit dhe testimit të materialeve dhe produktet që përdorin standarde të miratuara. Testet zhvillohen në një rrjet laboratorësh që operojnë sipas rregullave dhe rregulloreve të bazuara në standarde. Metrologjia (shih më poshtë) siguron shërbime që garantojnë se pajisjet e përdorura në testime kryejnë matje të sakta. Për më tepër, akreditimi (shih më poshtë) është gjithashtu pjesë përbërëse e Sistemit të Infrastruktura të Cilësisë në një vend, me qëllim që të sigurohet se të gjitha pjesët e Sistemit të Infrastruktura të Cilësisë operojnë sipas standardeve përkatëse me anë të vlerësimit të kompetencës së Organeve të Vlerësimit të Konformitetit. Shih Bashkëlidhjen B për informacion të mëtejshëm mbi infrastrukturën e cilësisë.

Metrologjia

Fusha e njohurisë në lidhje me matjet (Fjalori Ndërkombëtar i Termave Bazë dhe të Përgjithshme në Metrologji, 2004). Metrologjia përfshin të gjitha aspektet teorike dhe praktike të matjeve, ciladoqoftë pasaktësia e matjes dhe fusha e zbatimit.

Metrologjia mund të klasifikohet në tre grupe. Sipas përkufizimeve të deklaruara në Metrologjia e Përmbledhur, Botimi i dytë, dhjetor 2003, ato klasifikohen si më poshtë:

Metrologjia shkencore merret me organizimin dhe zhvillimin e standardeve të matjeve dhe me ruajtjen e tyre (niveli më i lartë).

Metrologjia industriale duhet të sigurojë funksionimin e mjaftueshëm të instrumentave të matjeve të përdorura në industri, si dhe në proceset e prodhimit dhe testimit. Në përgjithësi, këto janë laboratore dytësore të akredituara për kalibrim, testim dhe analizë materiale.

Metrologjia ligjore ka lidhje me matjet ku këto ndikojnë në transparencën e tranzaksioneve ekonomike, shëndetin dhe sigurinë.

Një aspekt i Metrologjisë Shkencore është vendosja dhe ruajtja e Standardeve Kombëtare të Matjeve që përcaktohen si standarde të vendosura si referenca metrologjike të deklaruara kombëtare.

Zinxhiri i gjurmueshmërisë

Një zinxhir gjurmueshmërie është një zinxhir i sistemeve të masave alternuese me procedurat përkatëse të matjeve dhe standardet e matjeve, nga një rezultat matjeje në një referencë të deklaruar metrologjike. Një zinxhir i gjurmueshmërisë metrologjike përcaktohet nëpërmjet një hierarkie kalibrimi nga rezultati i matjeve në referencën e deklaruar metrologjike. (International Vocabulary of Basic and General Terms in Metrology, 2004- Fjalori Ndërkombëtar i Termave Bazë dhe të Përgjithshme në Metrologji, 2004)

Kalibrimi

Operacion që vendos marrëdhënie ndërmjet vlerave sasiore të dhëna nga standardet e matjeve dhe treguesit korrespondues të një sistemi matjesh, të kryer sipas kushteve të specifikuara dhe duke përfshirë vlerësimin e pasaktësisë së matjeve.

Kalibrimi gjithashtu përkufizohet si operacion që vendos marrëdhënie, të përfuara nga referenca e një ose më shumë standardeve të matjeve që egzistojnë sipas kushteve të specifikuara, midis treguesit të një sistemi matjesh dhe rezultatit të matjeve që do të arrihej duke përdorur sistemin e matjeve.

(International Vocabulary of Basic and General Terms in Metrology, 2004- Fjalori Ndërkombëtar i Termave Bazë dhe të Përgjithshme në Metrologji, 2004)

Verifikimi

Konfirmimi nëpërmjet shqyrtimit të një artikulli të dhënë dhe sigurimit të provave objektive që përbushin kërkesat specifike. Verifikimi nuk duhet të ngatërrohet me kalibrimin e një sistemi matjesh ose anasjelltas.

(International Vocabulary of Basic and General Terms in Metrology, 2004)

Testimi i Produktit (Testimi)

Përcaktimi i një ose më shumë karakteristikave të një objekti të vlerësimit të pajtueshmërisë sipas një procedure. (ISO/IEC 17000:2004)

Standardi

Dokument, i miratuar nga një organ i njohur, që për përdorim të përsëritur ose të përgjithshëm, përcakton rregulla, udhëzime apo karakteristika për produkte ose procese që lidhen me to dhe metodat e prodhimit, zbatimi i të cilit nuk është i detyrueshëm. Ai mund të përmbajë gjithashtu ose mund të trajtojë ekskluzivisht terminologjinë, simbolet, ambalazhimin, markimin ose kërkesat e etiketimit që kanë të bëjnë me produktin, procesin apo metodën e prodhimit (OBT).

Çertifikimi

Vërtetimi i palës së tretë që ka lidhje me produktet, proceset, sistemet ose personat. (ISO/IEC 17000:2004)

Akreditimi

Vërtetimi i palës së tretë që ka lidhje me një organ vlerësimi pajtueshmërie që transmeton demonstrimin formal të kompetencës së tij për të përmbushur detyra specifike të vlerësimit të pajtueshmërisë. (ISO/IEC 17011:2004)

Testimi i efektivitetit

Përcaktimi i performancës së testimit laboratorik me anë të krahasimeve ndërlaboratorike.

(Glossary of Analytical Terms. Eurachem Education & Training Working Group- Fjalorthi i Termave Analitike Eurachem Grupi i Edukimit & Trajnimit)

Vlerësimi i Konformitetit

Aktivitet që tregon se janë përmbushur kërkesat specifike në lidhje me një produkt, proces, sistem, person ose organ. (ISO/IEC 17000:2004)

Hyrje

Në një shoqëri ideale të tregut të lire, gjithçka merret përsipër nga sektori privat dhe tregu vendos rregullat e prodhimit dhe tregtisë. Megjithatë, në praktikë, çdo vend ka një sektor publik dhe shteti rregullon disa aktivitete të sektorit privat, veçanërisht në fushat e prodhimit, shërbimeve dhe tregtisë. Çështja është se cilat fusha rregullohen dhe në ç'mënyrë rregullohen ato. Në botën globale, kjo krijon probleme pasi rregullore të ndryshme në vende të ndryshme sjellin vështirësi serioze për prodhuesit dhe tregtarët ndërkufitarë. Ky problem përkeqësohet për mallrat e prodhuara sepse rregullore të ndryshme mund të pengojnë shitjen e produktit të prodhuar nga një vend për një vend tjetër. Një shembull i mirënjohur është makina. Disa vende përdorin drejtimin e automjetit në korsinë e djathtë ndërsa pjesa tjetër përdorin korsinë e majtë. Kjo i detyron prodhuesit të prodhojnë dy sete të ndryshme makinash. Ka shumë shembuj të këtij lloji. Disa vende përdorin sistemin rregullor si pengesë ndaj tregtisë me qëllim mbrojtjen e industrive të tyre të prodhimit. Kjo e bën shumë të rëndësishëm faktin që të gjitha vendet tregtuese të kenë një sistem eficient rregullator teknik.

Një sistem i mirë rregullator kërkon dy elemente thelbësore. Rregulla të mira dhe monitorim të mirë. Nga njëra anë, kjo kërkohej me synim mbrojtjen e konsumatorit dhe shtetit dhe nga ana tjetër të mos vendosë kufizime të panevojshme për të bërë biznes në atë vend. Ky optimizim i rregullave teknike varet gjerësisht nga infrastruktura e disponueshme. Elementët kyç të infrastrukturës janë standardizimi (për rregullat), inspektimi, matja dhe akreditimi (për monitorimin). Ky sistem me shkurtim njihet me termin IC.

Në botën e cila ndryshon me ritme të shpejta, në të cilën globalizimi po bëhet gjithnjë e më i rëndësishëm, të gjitha vendet e industrializuara po përpiqen të harmonizojnë sistemet e tyre rregullatore dhe infrastrukturën e tyre, me qëllim që të nxisin prodhimin dhe tregtinë. Shqipëria është një prej vendeve që është angazhuar për praktikën e OBT dhe BE-së për tregtinë e saj ndërkombëtare. Fatkeqësisht, sistemi egzistues i infrastrukturës se cilesise në Shqipëri nuk është i pajtueshëm me sistemin ndërkombëtar. Ky dokument i strategjisë zhvillimit të infrastrukturës së cilësisë parashtron objektivat për vitin 2012, 2017 dhe 2022, dhe një "plan veprimi" për tranzicion të butë dhe eficient në Sistemin e Infrastrukturës së Cilësisë dhe Rregulla Teknike të pajtueshme në nivel ndërkombëtar gjatë periudhës së 15 viteve.

Tranzicioni kërkon investime të mëdha në mjedise, pajisje dhe zhvillimin e burimeve njerëzore, si dhe në riorganizimin e stabilimenteve MSTQ egzistuese dhe mund të kërkojë gjithashtu disa rregullime ligjore. Me infrastrukturën e përmirësuar, do të zhvillohen gjithashtu rregullat teknike dhe sistemet e mbrojtjes së konsumatorit.

Nëse ndiqet nga afër, ky dokument jep informacionin e nevojshëm, me qëllim arritjen e një sistemi modern MSTQ që nuk nevojitet vetëm për një sistem të mirë rregullator por edhe për zhvillimin e shpejtë të industrisë prodhuese. Gjatë 15 viteve, Shqipëria do të ketë një infrastrukturë të rëndësishme në fushën MSTQ dhe do të jetë në gjendje të sigurojë shërbime për vendet e tjera, duke kompensuar kështu disa prej shpenzimeve.

Kjo Strategji MSTQ parashikon më shumë se 150 objektiva dhe më shumë se 250 veprime specifike që duhen ndërmarë. Kostot e investimit për implementimin e kësaj strategjie do të jenë afërsisht 29 milionë Euro gjatë 15 viteve, por përfitimet e drejtpërdrejta për ekonominë do të jenë 52-58 milionë Euro dhe përfitimet jo të

drejtpërdrejta do të jenë rreth 300 milionë Euro, nëse tendencat aktuale në ekonomi vazhdojnë me ritmin egzistues.

Rëndësia strategjike e Sistemit të Infrastrukturës së Cilësisë

Siç është shpjeguar në seksionin e Hyrjes, sistemi IC është elementi kyç për infrastrukturën e cilësisë së një vendi. Gjithashtu, është thelbësore në proceset e ngjashme të OBT-së dhe për lëvizjen e lirë të mallrave nga pikëpamja e BE-së. Sistemi IC është gjithashtu i rëndësishëm për mbrojtjen e tregut të brendshëm nga importet e cilësisë së ulët.

Në shumë vende, sistemet e avancuara të matjeve janë një prej forcave shtytëse për industrinë prodhuese dhe shumë ambjente testimi përdoren për zhvillimin e produkteve të reja. Pasja e një sistemi të mirë IC ndihmon gjithashtu në zhvillimin e sektorit të prodhimit të pajisjeve të matjeve. Shërbimet në lidhje me matjet përbëjnë afërsisht 8% të Prodhimit Kombëtar Bruto në shumë vende të zhvilluara ose vende në zhvillim.

Me qëllim krijimin e një mjedisi të favorshëm në të cilin mjedisi sipërmarrës dhe administrata publike do të dëshironin të arrinin nivelin më të lartë të cilësisë së produkteve në favor të të gjithë shoqërisë, nxitja e një kulture Europiane është e nevojshme me anë të zhvillimit të instrumentave dhe burimeve teknike dhe njerëzore, në partneritet me industrinë dhe aktorë të tjerë.

Lëvizja e lirë e mallrave do të mund të arrihej vetëm duke eliminuar masat që kufizojnë tregtinë, jo vetëm detyrimet doganore dhe kufizimet sasiore, por të gjitha masat me efekt të barazvlefshëm (proteksionizmi). Kjo imponon egzistencën e një kuadri të përbashkët legjislativ që do të siguronte qarkullimin e mallrave pa kufizim mes vendeve. Kjo nënkupton se infrastruktura e cilësisë (IC) duhet t'i nënshtrohet disa rregullave të vendosura në nivel europian dhe ndërkombëtar.

Në Shqipëri, instrumentat në lidhje me IC do të jenë rreth 29 milionë Euro brenda një periudhe prej 15 vjetësh. Edhe nëse një pjesë e vogël (10%) e këtij investimi nuk është përmbyshur në mënyrën e duhur, kjo do të sillte në humbjen e burimeve mjaft të rëndësishme për Shqipërinë. Kështu, përdorimi i fondeve në dispozicion është mjaft i rëndësishëm. Shqipëria është prapa në fushën e IC në Ballkan dhe në Europën Lindore. Ka një hendek të madh midis Shqipërisë dhe vendeve fqinje të saj dhe partnerëve të saj tregtarë. Ky hendek duhet të ngushtohet në të ardhmen e afërme, nëse Shqipëria dëshiron një pjesë më të mirë të tregtisë dhe që të tërheqë investime të huaja më të drejtpërdrejta. Kjo nuk mund të arrihet pa një strategji të mirëpërgatitur dhe të mirëmenduar meqë fondet në dispozicion të Shqipërisë janë mjaft të kufizuara në fushën e IC në krahasim me të gjithë fqinjët e saj dhe partnerët tregtarë. Meqë sistemi IC është një prej shtyllave të prodhimit, tregtisë dhe zhvillimit ekonomik, një Strategji IC e mirëpërgatitur dhe e zbatuar në mënyrën e duhur do të ketë ndikim të rëndësishëm në zhvillimin e Shqipërisë dhe mirëqënien e popullit shqiptar. Një vlerësim i kostove dhe përfitimeve mund të gjëndet me tej në këtë punim.

Në zhvillimin industrial të një kombi, tendenca e përgjithshme duhet të shkojë kryesisht nga një shtet bujqësor në një shtet industrial. Shenjat e para të industrializimit janë tekstilet dhe ushqimi i parapërpunuar. Më tej, pason industria e lehtë si dhe teknologjitë e informacionit. Ne shohim gjithashtu këto zhvillime në Shqipëri. Të gjitha këto industri përdorin fillimisht makineri të furnizuara nga jashtë dhe ekspertizë të huaj. Megjithatë, në fazat e mëvonshme të evolucionit industrial, kërkimi dhe zhvillimi bëhen më të rëndësishëm dhe zhvillohet dhe përdoret ekspertiza lokale. Shqipëria do ta arrijë këtë fazë brenda 15 viteve të ardhshme. Kur të ndodhë kjo, institutet e metrologjisë do të jenë një prej qendrave më të rëndësishme për sistemet e sofistikuara dhe novacionin.

I. Vështrim i përgjithshëm mbi situatën aktuale të sistemit të infrastrukturës së cilësisë

Shikim i përgjithshëm dhe analizë e sistemit egzistues të IC në Shqipëri. Më poshtë jepet një përmbledhje e shkurtër.

a. Rregullat Teknike dhe Standardizimi

Rregullat Teknike

1. Legjislativ Horizontal

- Përgjegjësia e Produktit

Dispozitat e direktivave të BE-së 85/374/EEC (amenduar nëpërmjet 1999/34/EC) mbi përgjegjësinë për produktet defekte (Direktiva e Përgjegjësisë së Produktit) janë transpozuar në mënyrë të plotë në Kodin Civil Shqiptar.

- Siguria e Produktit, Vlerësimi i Pajtuashmërisë

Parlamenti shqiptar ka miratuar ligjin nr.9779, dt.16.07.2007 "Mbi Sigurinë e Përgjithshme, Kërkesat Thelbësore dhe Vlerësimin e Konformitetit të Produktet", të hartuar nga METE, me asistencën e dhënë nga EC nepermjet programit CARDS 2003, Projekti "Mbikëqyrja e Tregut në Shqipëri".

Ky ligj horizontal

- Transponon Direktivën e Sigurisë së Përgjithshme të Produkteve 95/2001/EEC,

- Transponon elementët e përbashkët të direktivave të përafërimit të ri.

- I referohet shprehimisht moduleve të vlerësimit të konformitetit, siç janë renditur në vendimin e KE-se 93/465/EEC

- Autorizon ministrinë të linjës për transpozimin e direktivave të produkteve, siç janë renditur në shtojcën

e ligjit. Kjo listë është e barazvlefshme me listën e direktivave të përafërimit të ri.

- Formon bazën ligjore për aktivitetet e mbikeqyrjes së tregut

Qeveria e Shqipërisë është angazhuar më tej për të miratuar markën CE si markë konformiteti.

2. Legjislacioni Vertikal (produkti)

Ministria e Integrimit Europian, në bashkëpunim me ministrinë e linjës, ka hartuar një plan ambicioz për transpozimin e *acquis communautaire* të BE-së në legjislacionin kombëtar shqiptar.

Ministria e Shëndetësisë është përgjegjëse për transpozimin e tre direktivave mbi pajisjet mjekësore, si dhe legjislacionin e BE-së në lidhje me Kozmetikën.

Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit është përgjegjëse për transpozimin e direktivave të BE-së në lidhje me Materialet e Ndërtimit, RTTE, Automjetet (duke përfshirë traktorët agropjorë), për Profesionet Argëtuese dhe Pajisjet Detare. Ministria e Mbrojtjes është përgjegjëse për ATEX. Ministria e Bujqësisë është përgjegjëse për transpozimin e *acquis* në lidhje me Produktet Ushqimore.

METE është përgjegjëse për transpozimin e

Versionit përfundimtar të Direktivës	Subjekti (titulli i shkurtër i direktivës)
73/23/EEC	Voltazhi i Ulët
89/336/EEC	Pajtueshmëria elektromagnetike (EMC)
87/404/EEC	Enë të thjeshta me presion
88/378/EEC	Siguria e lodrave
97/23/EC	Pajisjet me presion
94/9/EC	Atmosferat eksplozive të pajisjeve (ATEX)
94/62/EC	Ambalazhimi dhe mbetja e ambalazhimit
96/57/EC	Kërkesat e efikasitetit të energjisë për frigoriferët shtëpiakë elektrikë, ngrirësat dhe kombinimet e tyre
73/404/EEC, 73/405/EEC, 82/242/EEC, 82/243/EEC	Detergjentë
2002/96/EC	Pajisje mbetjesh elektrike dhe elektronike (WEEE)
98/37/EC	Makinëri
95/16/EC	Ashensorë
89/686/EEC	Pajisje personale mbrojtëse (PPE)
90/396/EEC	Pajisje që djegin karburant të gaztë
92/42/EEC	Kërkesat e efikasitetit për bojëra të reja me ujë të ngrohtë që ndizen me karburant të lëngshëm ose të gaztë
	Druri
96/74/EEC, 97/73/EEC, 73/44/EEC	Tekstilet
99/411/EEC	Këpucë
64/493/EEC	Qelqurina
2000/9/EC	Instalimet e teleferikut me shina, të dizenuara për transportin e personave

1999/36/EC	Pajisje me presion të transportueshme
2000/55/EC	Kërkesat e efijencës së energjisë për balastet për ndriçimin fluoreshent
92/75/EC	Etiketimi i energjisë për pajisjet elektroshtëpiake
90/384/EEC	Instrumenta peshimi jo-automatike
2004/22/EC	Instrumenta matëse

Nuk janë caktuar direktivat e mëposhtme

93/15/EEC	Lëndë plasëse për përdorime civile ¹
2000/14/EC	Emetimi i zhurmës në mjedis nga pajisje për përdorim në ambiente të jashtme ²
67/548/EEC	Klasifikimi, ambalazhimi dhe etiketimi i substancave të rrezikshme
76/769/EEC	Kufizimet në marketing dhe përdorimi i disa substancave dhe preparateve të rrezikshme
1999/45/EC	Klasifikimi, ambalazhimi dhe etiketimi i substancave të rrezikshme

por ka të ngjarë të përfshihen në detyrat e METE-s.

3. Transpozimi

Direktivat e Perafrimit të Ri janë transpozuar në formën e Vendimeve të Këshillit të Ministrave. METE duhet të hyjë në diskutime me ministrinë e tjera teknike për të vendosur mbi mënyrën më të përshtatshme në lidhje me transpozimin e direktivave të Perafrimit të Vjetër.

Me mbështetjen e projektit të lartpërmendur CARDS, METE ka përgatitur tre Vendime të Këshillit të Ministrave që transpozojnë përkatësisht:

- Direktiven 88/375/EEC të Lodrave;
- Direktiven 87/404/EEC të Enëve të Thjeshta nën Presion;
- Direktiven 97/23/EC të Pajisjeve nën Presion.

Një projekt i asistencës teknike i financuar nga bashkëpunimi gjerman GTZ, ka asistuar DPMK me transpozimin e 90/384/EEC. Instrumentat e peshimit jo-automatike (NAWI) dhe me përgatitjen e transpozimit të 2004/22/EC. Instrumentat Matëse (MID).

4. Mbiqyrja e tregut

Sistemi i Mbiqyrjes së Tregut u paraqit në Këshillin e Ministrave në korrik 2006. Egziston një konsensus i përgjithshëm mes aktorëve mbi këtë sistem, i cili është pjesë e Strategjisë Ndersektoriale “Për Mbrojtjen e Konsumatorit dhe Mbiqyrjen e Tregut për periudhën 2008 – 2013”, e miratuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.797, dt.14.11.2007.

Legjislacioni horizontal i sipërpërmendur përcakton një ose më shumë organe për kryerjen e aktiviteteve të Mbiqyrjes së tregut, në varësi të ministrisë së linjës përgjegjëse për direktivën.

Inspektorati Qendror Teknik do të jetë struktura e mbiqyrjes së tregut e METE-s. Instituti i Ndërtimit, Tiranë, ka gjasa të jetë struktura e mbiqyrjes së tregut për produktet e ndërtimit.

Struktura të tjera të mbiqyrjes së tregut nuk janë bërë të njohura ende.

Stafi i Inspektoratit Qendror Teknik ka marrë trajnimin e parë mbi kryerjen e aktiviteteve të mbiqyrjes së tregut mbi lodrat dhe mbi enët e thjeshta nën presion.

Standardizimi

Aktivitetet e standardizimit janë kryer në Shqipëri nga Drejtoria e Përgjithshme e Standardizimit, (DPS), duke i raportuar më parë Kryeministrit dhe aktualisht Ministrit përgjegjës për ekonominë (METE).

Standardizimi filloi në korrik 1950.

Në vitin 1956 Shqipëria u bë anëtare e ISO-s.

¹ Sipas shtojcës së ligjit horizontal, kjo direktivë është nën përgjegjësinë e Ministrisë së Mbrojtjes.

² Sipas shtojcës së ligjit horizontal, kjo direktivë është nën përgjegjësinë e Ministrisë së Mjedisit.

Ndërmjet periudhës së viteve 1966 dhe 1972, aktivitetet e standardizimit u ndërprejnë dhe anëtarësia e DPS në ISO u pezullua. Të dyja rifilluan në vitin 1973.

Në 1995 DPS u pranua si antar pa të drejtë vote në CEN.

Në 2000 Shqipëria u pranua si anëtare e OBT dhe DPS u caktua si autoritet kombëtar notifikues dhe pikë referimi.

Që prej vitit 2001, DPS është antar pa të drejtë vote në CENELEC dhe IEC.

Në vitin 2002, Shqipëria adoptoi direktivën 98/34/EC dhe DPS u caktua për përmbushjen e detyrave në lidhje me standardizimin që rrjedhin nga direktiva që parashtron një procedurë për sigurimin e informacionit në fushën e standardeve teknike.

Në vitin 2004, aktivitetet e akreditimit janë hequr nga DPS dhe i janë besuar Drejtorisë së Përgjithshme për Akreditim të krijuar kohët e fundit (DA) që i raporton ministrisë përgjegjëse për ekonominë (METE).

Në vitin 2006 DPS, me rekomandim të BE, mbylli aktivitetet e saj të certifikimit.

Në vitin 2005, DPS mori certifikimin e sistemit të saj të menaxhimit të cilësisë kundrejt ISO 9001:2000 i. Mandati për DPS

Sipas versionit më të fundit të projektligjit³ DPS do të ketë mandate për të:

- zhvilluar, miratuar dhe amenduar rregullat dhe procedurat e punës mbi aktivitetet e standardizimit kombëtar;

- përgatitur dhe propozuar udhëzime dhe orientim metodologjik për përpunimin e standardeve;

- përgatitur, miratuar dhe publikuar programin e punës të standardizimit në përputhje me interesat e palëve në standardizim;

- zhvilluar, pranuar dhe miratuar ose implementuar, konfirmuar, amenduar ose tërhequr Standardet Shqiptare dhe dokumentat shqiptare të standardizimit;

- shpërndarë draft standardet shqiptare, Standardet Shqiptare, draft dokumentat shqiptare të standardizimit dhe dokumentat shqiptare të standardizimit;

- miratuar standardet europiane dhe ndërkombëtare si standarde kombëtare shqiptare

- shpërndarë draft standardet europiane, draft standardet ndërkombëtare, standardet ndërkombëtare, draft standardet e huaja kombëtare dhe standardet e huaja kombëtare;

- deleguar të drejtat e shpërndarjes për draft standardet shqiptare, standardet shqiptare, draft dokumentat shqiptare të standardizimit dhe dokumentat shqiptare të standardizimit ndaj një pale të tretë brenda territorit të Republikës së Shqipërisë;

- përpunuar dhe menaxhuar një bazë të dhënash të standardeve dhe dokumenteve të standardizimit;

- përpunuar dhe menaxhuar një arkivë të standardeve kombëtare, ndërkombëtare, Europiane dhe standarde të huaja kombëtare dhe një bibliotekë të specializuar;

- dhënë shërbime informacioni sipas kërkesave të enteve kombëtare dhe të huaja që ushtrojnë aktivitete ekonomike në Republikën e Shqipërisë;

- përmbushë detyrat në lidhje me standardizimin që rrjedhin nga Marrëveshja e Organizatës Botërore të Tregtisë mbi Barrierat Teknike në Tregti dhe Direktivës së Bashkimit Europian 98/34/EC të datës 22 qershor 1998 (amenduar nga Direktiva 98/48/EC e datës 20 korrik 1998) që parashtron një procedurë për sigurimin e informacionit në fushën e standardeve dhe rregullave teknike dhe rregullave mbi shërbimet e shoqërisë së informacionit;

- ndërmarrë me organe të tjera standardizimi shkëmbimin e standardeve dhe bashkëpunuar me organet kombëtare të standardizimit nga vende të tjera në fushën e standardizimit;

- organizuar kurse trajnimi, seminare, konferenca dhe ngjarje të tjera për nxitjen e pjesëmarrjes së zgjeruar në aktivitetet kombëtare të standardizimit;

- publikuar një buletin zyrtar dhe një katalog të Standardeve Shqiptare;

- publikuar një raport vjetor të aktiviteteve të saj;

- nxitur studimet, publikimet, përvojën dhe kërkimin që trajton standardizimin dhe aktivitetet e ngjashme. Kjo do të përfshijë nxitjen dhe bashkërendimin e iniciativave të një karakteri shkencor, teknik, të zbatueshëm dhe kulturor që kanë lidhje me standardizimin;

- propozuar akte ligjore dhe rregullatore mbi aktivitetet që mbulon;

- propozuar tarifa Ministrisë së Financave për çmimin e shërbimeve të kryera për palët e treta.

Enti Rregullator i Telekomunikacionit kryen aktivitetet e standardizimit në fushat e Telekomunikacionit.

ii. Kuadri ligjor

Me asistencën e projektit CARDS 2003, mbi Standardet, Certifikimin dhe Akreditimin, është hartuar një projekt ligj i ri “Mbi standardizimin”. Ky ligj është miratuar nga Kuvendi dhe pritet shpallja në Fletoren Zyrtare.

iii. Marrëveshje qeverisjeje

³ Disa klauzola mund të jenë ndryshuar në versionet e mëtejshme të projektligjit.

Menaxhimi dhe administrimi

Projektligji në fakt konfirmon statutin aktual të DPS si një agjensi qeveritare që i raporton METE-s, megjithëse BE rekomandon⁴

Karakteristikat kryesore të Institutit

- Pavarësia (preferohet një organ privat, jo i emëruar nga autoritetet publike).

- Procesi i vendimmarrjes është nxitur nga konsensusi.

- Procesi i vendimmarrjes është transparent.

- Të gjithë interesat dhe jo vetëm ato të administratës publike janë përfaqësuar si në aktivitete dhe në bordet e menaxhimit të organit të standardizimit (industria, konsumatorët, certifikuesit, akredituesit, organizatat tregtare dhe profesionale etj).

- Pjesëmarrja e palëve të interesuara është vullnetare.

- Rezultatet e punës së Institutit janë të hapura për publikun dhe mund të përdoren nga kushdo.

- Aktivitetet teknike

Rregullat dhe procedurat e brendshme të referuara në projektligj supozohen për kohën në vazhdim të mos jenë tërësisht në pajtim me Rregullat dhe Procedurat e Brendshme të CEN/CENELEC. Ato po rishikohen me këtë pikësynim.

Këto rregulla dhe procedura janë të disponueshme vetëm në gjuhën shqipe. Ato mbulohen pjesërisht nga Sistemi i Cilësisë DPS.

Aktivitetet teknike (programi i punës 6 mujor i përgatitur nga DPS) miratohen nga GES (Grupi i Ekspertëve të Standardizimit) që vepron si Bord Teknik. GES ka 21 anëtarë, ku përfaqësohen institucione shkencore, biznesi, konsumatori. Një pjesë e antarëve të GES janë gjithashtu antarë (drejtues) në Komitetet Teknike (KT).


DPS ka krijuar 67 Komitete Teknike (84% janë komitete pasqyrë CEN/CENELEC) që numërtohen përkrah me numërtimin CEN / CLC TC.

Stafi i DPS mbështet sekretariatit e të gjitha KT-s. Sipas DPS, 10 deri 12 KT-s janë pasive. Anëtarët KT kryesisht vijnë nga sektori publik

(universiteti, institutet teknike shtetërore...).Përfshirja e sektorëve industriale në punën KT mbetet e ulët.

⁴ “Strukturat kryesore administrative të kërkuara për implementimin e acquis” dokumenti informal i punës i BE, qershor 2004

Organigrama



- Zhvillimi i burimeve njerëzore

DPS ka një organikë prej 18 vetash.

Personeli dhe Organizimi:

4

Drejtoria e Standardizimit:

8 (duke përfshirë IT)

Drejtoria e Integritetit Europian:

5

1 pozicion është aktualisht i lirë në sektorin CENELEC / IEC (specialist, i cili duhet të rekrutohet nga fundi i vitit 2008). DPS ka lëvizje të shumta të personelit. Në 10 vitet e fundit, 25 % e stafit është larguar nga organizata. Kryesisht për shkak të rrogave të ulta, DPS ka vështirësi në mbajtjen e personelit të trajnuar dhe të kualifikuar.

Kualifikimi dhe kompetenca e stafit teknik është e kënaqshme; niveli i gjuhës së huaj (anglisht) duhet rritur.

DPS nuk ka plan zhvillimi për burimet njerëzore dhe mbështetjen në asistencën e jashtme (BE, GTZ...) për trajnim të brendshëm ose aktivitete ritrajnuese. Projektet CARDS kanë bërë trajnime për stafin e standardizimit të DPS, i cili tashmë ka njohuri të detajuara të të gjitha proceseve europiane të standardizimit dhe është i ndërgjegjshëm sesi një organ tërësisht funksional i standardeve kombëtare europiane duhet të operojë në përputhje me praktikën CEN dhe CENELEC.

Rekrutimet e reja i nënshtrohen një rritjeje buxheti që kërkon miratimin e Ministrisë.

Aktivitetet

- Aktivitetet e Standardizimit

DPS harton programin gjashtëmujor të punës për secilën KT që miratohet nga GES dhe përmbushet nga KT. Programi i punës konsiston kryesisht në një listë të Standardeve Europiane që duhet të miratohen si standarde kombëtare shqiptare. Metoda e përdorur për miratim është metoda e faqes së parë.

Sic është deklaruar më sipër, Standardet Europiane (EN) janë adoptuar në grup brenda një intervali prej gjashtë muajsh. DPS ka arritur në 2007-05-31 transpozimin e:

9238 standarde EN të CEN (nga totali prej 11062)

2090 standarde EN të CENELEC (nga totali prej 4750)

ose 11328 EN, nga përmbledhja totale e 15812 EN të CEN dhe CENELEC

DPS nuk ka linjë buxheti dhe për pasojë asnjë program për përkthimin e Standardeve Europiane në gjuhën shqipe. Kështu, ajo mbështetet në programet e asistencës së jashtme për lehtësimin e këtij aktiviteti (GTZ mbështeti përkthimin e 58 Standardeve Europiane (ENs). Programi CARDS ka financuar kohët e fundit

përkthimin e disa standardeve të sistemit të cilësisë (ISO 900x, ISO 22000...). Standardi i terminologjisë ISO 17000 tashmë është përkthyer. Megjithatë, grupi i Standardeve Europiane të Harmonizuara të përkthyer (që japin prezumimin e konformitetit me kërkesat e direktivave) mbetet mjaft i varfër. Rreth 5% e përmbledhjes kombëtare të standardeve është përkthyer në gjuhën shqipe.

Për kohën në vazhdim, DPS nuk zhvillon standarde kombëtare.

DPS informon rregullisht CEN dhe CENELEC mbi miratimin e standardeve Europiane në përputhje me Direktiven 98/34/EC dhe ISO në përputhje me Kodin e Praktikës së Mirë për Standardizimin të OBT-së.

Megjithë mungesën e rregullave teknike që japin një nivel minimal të sigurisë së produkteve të disponueshme në tregun shqiptar, DPS ka negociuar me disa ministri të linjës për shfuqizimin e shumë prej standardeve të detyrueshme që rregullojnë tregun. DPS i ka kërkuar METE-s të shfuqizojë standardet shqiptare që ende referohen në vendimet e Këshillit të Ministrave, si të detyrueshme, por METE shpjegoi se ato nuk mund të tërhiqen derisa të vihet në funksionim një legjislacion teknik.

- Publikimi dhe shitjet

DPS publikon çdo vit katalogun e saj të standardeve të printuar dhe në CD ROM dhe e publikon në faqen e saj të internetit. Raporti vjetor publikohet vetëm në gjuhën shqipe. Buletini del 4 herë në vit në format elektronik dhe publikohet në faqen e internetit të DPS.

Shitjet e standardeve arritën në vitin 2006 në 574 standarde, kryesisht në sektorët: ushqimorë, të materialeve të ndërtimit, naftës dhe menaxhimit të cilësisë (ISO 900x, ISO 170xx, ISO 22000 – të gjitha të disponueshme në gjuhën shqipe). Çmimet e shitjeve janë 30 deri 35% më të ulta sesa çmimet e BE-së.

Programet CARDS 2001 dhe 2003 trajnuan stafin e Marrëdhënieve Publike të DPS që mund zhvillojnë marrëdhënie me median dhe hartimin e njoftimeve efektive për shtyp, mbështetjen zhvillimin e faqes së internetit DPS (<http://www.dps.gov.al>) për nxitjen efektive të shërbimeve DPS dhe zhvillimin e publikimeve promocionale, duke përfshirë broshura, Raportin Vjetor DPS, publikime informative rreth Standardeve Europiane dhe rregullave teknike (duke përfshirë Përafrimin e Ri).

- Standardizimi ndërkombëtar

Pjesëmarrja DPS në Komitetet Teknike CEN dhe CENELEC (TCs) është si më poshtë:

CEN TC 250: Eurokodet strukturore;

CEN TC 254: Fletët sintetike kundër ujit; dhe

CENELEC TC 46X: Kabllot me bosht të përbashkët.

Projekti CARDS lejoi stafin DPS (sekretarin KT dhe kryetarin KT) të merrnin pjesë në mbledhjet e këtyre KT.

KT të tjera të DPS regjistrohen për të marrë pjesë në punimet e KT të CEN, si më poshtë:

CEN TC 19: Karburante të gaztë dhe të lëngshme

CEN TC 154: Agregatet

CEN TC 175: Lëndë drusore të plota dhe të sharruara

CEN TC 275: Analiza ushqimore – metodat horizontale

DPS nuk merr pjesë në punimet e KT të ISO-s ose IEC.

- Aktivitete të tjera

DPS ka mbyllur aktivitetet e saj të certifikimit në vitin 2006. Arsyeja e paraqitur është një rekomandim i BE, por edhe një kërkesë e pamjaftueshme për shërbime certifikimi. DPS ka kryer certifikimin e produktit (hekur, çelik) dhe certifikimin e personelit (subjektet e marrjes së mostrave).

Me qëllim trajtimin e përfshirjes së ulët të aktorëve joqeveritarë

(industria, konsumatorët, labororet) DPS organizon çdo vit në tetor një aktivitet me rastin e Ditës Botërore të Standardeve, por ka shumë pak mjete për të organizuar trajnime, informacion ose aktivitete mbi rritjen e ndërgjegjësimit.

Prërdhimisht, ajo mbështetet në programet e asistencës së jashtme për t'i lehtësuar ato. Projektet CARDS 2003 dhe 2006 kanë organizuar disa aktivitete dhe shfaqje në ambiente të hapura me synimin e rritjes së ndërgjegjësimit të aktorëve të mundshëm në lidhje me rolin dhe avantazhet e standardizimit dhe vlerësimit të pajtueshmërisë. Megjithatë, nuk ka gjasa që përfshirja e tyre të jetë rritur në mënyrë të ndjeshme.

Nxitja është bërë në një sërë sektorësh të përcaktuar, veçanërisht makineritë, pajisjet elektrike, pajisjet personale mbrojtëse dhe materialet e ndërtimit, me mbështetjen e Agjencive të Zhvillimit Rajonal. Këto sektorë janë përdorues të gjerë të standardeve dhe pritjet që të stimulohet kërkesa në të ardhmen.

DPS është një institucion qendror buxhetor (afërsisht 250.000 €/vit) i cilit miratohet nga METE. Buxheti i DPS mbulon rogat, shpenzimet operative dhe kuotat e anëtarësimit (27.000 €) të institucionit, si dhe një shumë për investime të vogla.

Ia vlen të theksohet se kur DPS të jetë anëtare me të drejta të plota në CEN dhe CENELEC, kuotat e anëtarësimit do të arrijnë një total prej rreth 60.000 €/vit

Programet e financuara nga BE-ja (PRAQ, CARDS) kanë paguar për gjysmën e kuotave të anëtarësimit të DPS në CEN dhe CENELEC nga viti 1994 deri në 2005. Programi CARDS 2003 ka paguar për abonimet DPS për një lidhje e tipit broadband me Internetin, me shpejtësi të lartë për periudhën e barazvlefshme me

kohëzgjatjen e projektit, në kohën kur buxheti i shtetit nuk ishte vënë në dispozicion për këtë qëllim të posaçëm, duke mundësuar kështu që DPS të ketë ende mundësi për të operuar në linjë me nëntë kushtet e CEN dhe CENELEC.

DPS gjithashtu mbështetet në programet e asistencës së jashtme për të financuar fuqishëm edhe investimet e buta ose aktivitetet e zhvillimit.

Metrologjia

i. Standardet Kombëtare të Matjeve

Për momentin, nuk ka objekte ose sisteme të caktuara zyrtarisht si standarde kombëtare. Megjithatë, disa objekte dhe sisteme përdoren si referenca matjeje në DPMK për kalibrime të brendshme ose të jashtme. Në koherencë me statistikën e nevojshme të mbledhura të matjeve dhe pjesëmarrjen në krahasimet ndërkombëtare, këto referenca matjesh mund të bëhen standarde kombëtare matjeje dhe mund të caktohen zyrtarisht.

ii. Funksionet e Institutit të Metrologjisë

Në nivel drejtorie jo institut autonom metrologjie.

Mjediset nuk janë të mjaftueshme.

Nuk egziston asnjë kontroll mjedisor profesional.

Shqipëria ka sistemin më pak të zhvilluar në rajon.

Mundësi matjeje mjaft të kufizuara në 14 fusha matjeje (15 së shpejti).

Asnjë mundësi në 101 fusha matjeje.

Nuk egziston asnjë plan ose program për zhvillimin e sistemit të metrologjisë në Shqipëri.

Shumë prej matjeve elektrike bëhen në Universitetin Politeknik të Tiranës.

Matjet e Rrezatimit Jonizues bëhen në Institutin e Fizikës Bërthamore.

Laboraret nuk janë të akredituara.

Gjurmueshmëria nuk është e kënaqshme.

Nuk është implementuar sistemi i cilësisë.

Laboraret klasifikohen midis kategorisë dytësorë shumë të ulët dhe dytësorë të lartë.

Asnjë krahasim ndërkombëtar ose testim efektiviteti nuk është përdorur përveç disa krahasimeve që shfrytëzojnë pajisje të vjetra.

Një pjesë e stafit ka trajnim të kufizuar.

Nuk ka staf të mjaftueshëm.

Nuk ka reparte riparimi e mirembajtje të përshtatshme, bibliotekë, infrastrukturë teknologjike informacioni.

Nuk ka mundësi riparimesh ose prodhimi për pajisjet e matjeve.

Nuk është kryer asnjë krahasim ose testim efektiviteti në Shqipëri.

Nuk ka vlerësues për akreditimin.

Nuk sigurohet asnjë trajnim për industrinë.

Nuk egziston asnjë mekanizëm fedbacku për klientin.

Nuk egziston asnjë funksion koordinimi kombëtar.

Nuk ka njohje ndërkombëtare.

iii. Kalibrimi

Janë bërë shumë pak kalibrime në DPMK.

Në këtë fazë, nuk egziston asnjë laborator i akredituar kalibrimi në Shqipëri.

iv. Infrastruktura e testimit

Janë bërë shumë pak testime në DPMK (vetëm në sigurinë elektrike).

Gjashtë laboraret e akredituara të testimit në Shqipëri në fushat e:

Ushqimit;

Ndërtimit;

Lëndëve plasëse.

v. Laboraret e specializuara

Të akredituara: Asnjë

Të paakredituara: Ushqimi

Veterinar

Zhvilluese Referenca e shëndetit

Referenca e mjedisit
Referenca mjekoligjore
Kontrolli i dopingut
Testimi i materialeve
Ndërtimi
Telekomunikacioni

vi. Verifikimi

Ka kater qendra rajonale në Fier, Lezhe, Korçe.

Ka 36 zyra në rrethe me aktivitet shumë të ulët.

Aftësitë e kufizuara të matjeve në

Pesha

Volum

Mallrat e paraambalazuara

Makineritë e lojrave të fatit (vetëm siguria elektrike, verifikimi i kufizuar e prom, asnjë test zgjedhjeje rastësore)

vii. Miratimi tip

Asnjë për kohën në vazhdim.

viii. Mbikqyrja metrologjike

12 anëtarë personeli.

Vetëm përcaktimi i sasisë së produkteve të paraambalazuara.

Vlerësimi i konformitetit dhe akreditimi

Akreditimi

i. Supozimet dhe rreziqet

Siç përcaktohet nga standardi i terminologjisë EN ISO/IEC 17000, akreditimi është “vërtetimi i palës së tretë që ka lidhje me një organ vlerësimi konformiteti që transmeton demonstrimin formal të kompetencës së tij për të përmbyshur detyra specifike të vlerësimit të konformitetit”.

Me fjalë të tjera, akreditimi është një konfirmim i kompetencës teknike të OVP-s të akredituara. Nëse OVPs kërkojnë pajtueshmërinë e objektit të vlerësuar me dokumentat referues, akreditimi kërkon saktësinë e rezultateve/gjykimeve të dhëna nga OVP-s. Duke thënë këtë dhe duke patur parasysh se të gjitha shërbimet e vlerësimit të pajtueshmërisë të ofruara nga të gjitha tipet e OVP-s nëkuptojnë të japin një vlerësim të karakteristikave të produkteve të vendosura në treg, është e qartë se akreditimi varet gjerësisht nga një sistem i besueshëm metrologjik. Për pasojë, një strategji që synon zhvillimin e infrastrukturës së vlerësimit të pajtueshmërisë mund të ndjekë vetëm zhvillimin e sistemit metrologjik. Kjo nënkupton se rreziku kryesor në lidhje me implementimin e strategjisë së akreditimit të zhvilluar sipas projektit aktual, ka lidhje me vonesat e mundshme në fushën e metrologjisë, duke ditur se krijimi ose përmirësimi i një sistemi metrologjik kërkon shumë përpjekje në lidhje me burimet financiare dhe njerëzore.

Nga ana tjetër, duke njohur përcaktimin dhe përkushtimin e anëtarëve të ekipit DPA, sapo sistemi metrologjik të bëhet operacional dhe i besueshëm, sistemi i akreditimit do të jetë në gjëndje të plotësojë të gjitha kërkesat për anëtarësimin në EA/MLA në fushat e përzgjedhura të veprimtimit brenda një kuadri kohor të arsyeshëm.

Një rrezik tjetër për implementimin e strategjisë është mungesa e pjekurisë për infrastrukturën e vlerësimit të pajtueshmërisë në Shqipëri, e lidhur ngushtë me dobësitë e ekonomisë, që duhet të mbështesë zhvillimin e OVP-s. Me përjashtim të laboratoreve të testimit, të gjitha kategoritë e tjera të OVP-s janë në fazën embrionale të zhvillimit të tyre. Kjo ka lidhje me zhvillimin aktual të ekonomisë dhe pritet që infrastruktura e vlerësimit të pajtueshmërisë të zhvillohet së bashku me industrinë që ka nevojë për shërbimet e saj.

ii. Vërejtje të përgjithshme

Aktiviteti i akreditimit ka filluar në vitin 1996 pranë DPS. Në vitin 2004, akreditimi u nda nga standardizimi dhe DPA, është krijuar si Organi i vetëm i Akreditimit Kombëtar në Shqipëri. DPA është një institucion qeveritar që i raporton Ministrin të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjitikës. Drejtori i DPA është përgjegjës për të gjitha vendimet mbi akreditimin, duke përfshirë dhënien, tërheqjen, pezullimin ose uljen e akreditimit.

DPA operon si në fushën vullnetare, edhe në fushën e rregulluar dhe jep akreditim për laboratorët e testimit dhe kalibrimit, organet e certifikimit (për sistemet e menaxhimit të cilësive, për certifikimin e produktit, për certifikimin e personelit), organet e inspektimit.

Aktiviteti i akreditimit bazohet në standardet e zbatueshme në seritë EN ISO/IEC 17000 dhe EN 45000.

DPA është anëtare e EA, Bashkëpunimi Europian për Akreditimin (që ka një kontratë bashkëpunimi) dhe një anëtar i asociuar i ILAC, Bashkëpunimit Ndërkombëtar të Akreditimit të Laboratoreve. Ajo synon të aplikojë sa më shpejt që të jetë e mundur për anëtarësim në IAF, Forumi Ndërkombëtar i Akreditimit.

Aktualisht, DPA përfundoi marrëveshje bashkëpunimi me ESYD, Greqinë dhe RENAR, Rumani, dhe po ofron mbështetje për sistemin e akreditimit në Kosovë.

Duke filluar nga viti 2004, DPA ka përfutur asistencë teknike nga Projekti CARDS 2003 dhe pjesërisht nga CARDS 2001, si dhe nga projekti rajonal CARDS 2002.

Deri tani, janë akredituar 6 laboratore testimi (për tekstilet, karburantet, materialet e ndërtimit, lëndët plasëse, detergjentët, prodhimet ushqimore) dhe 1 organ çertifikimi për produktet; po përpunohen rreth 25 aplikime të reja (22 laboratore testimi, 2 laboratore kalibrimi dhe 1 organ çertifikimi).

iii. Kuadri ligjor

Kuadri ligjor që rregullon aktivitetin e akreditimit në Shqipëri, si dhe organizimin dhe funksionimin e DPA-së përbëhet prej akteve të mëposhtme:

- Ligji nr.9824/01.11.2007 Mbi akreditimin e organizmave të vleresimit të konformitetit në Republikën e Shqipërisë;

- vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 854/19.12.2003 mbi organizimin dhe funksionimin e Drejtorisë së Akreditimit;

- urdhri i Kryeministrit nr. 124/03.08.2007 Mbi strukturën dhe organiken e DPA;

- vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 77/12.02.2004 Mbi strukturën dhe nivelin e pagave të punonjësve të DPA.

Ndërsa punonjësit e DA gëzojnë statusin e nëpunësit civil, duhet të citohet gjithashtu Ligji nr. 8459/11.11.1999 Mbi statusin e nëpunësit civil.

Me mbështetjen e projektit të asistencës teknike CARDS 2003 Mbështetje ndaj Standardeve, Çertifikimit dhe Akreditimit, janë propozuar amendime në legjislacionin e akreditimit, por ato nuk kanë hyrë ende në fuqi.

Përveç legjislacionit të përmendur më sipër, aktiviteti i akreditimit bazohet në standardet e zbatueshme (seritë EN 45000 dhe EN ISO/IEC 17000), siç kërkohen nga organizatat ndërkombëtare dhe europiane të akreditimit.

iv. Detyrat

DA është organi i vetëm i akreditimit që operon si në fushën vullnetare, dhe të detyrueshme dhe ka përgjegjësitë e mëposhtme:

- Të përfaqësojë Republikën e Shqipërisë në organizatat europiane dhe ndërkombëtare për akreditim;

- Të bashkëpunojë me organet kombëtare të akreditimit të vendeve të tjera për arritjen e marrëveshjeve të njohjes së ndërsjellë, rajonale ose ndërkombëtare, ose për arritjen e marrëveshjeve dypalëshe;

- Të japë konsulencë administratës shtetërore mbi tema që kanë lidhje me akreditimin dhe vlerësime të tjera të kompetencës teknike, për të përmbyshur procedura vlerësimi në pajtim me standardet dhe rregulloret teknike;

- Të mirëmbajë, përditësojë dhe sigurojë informacion në lidhje me statusin e akreditimit të organeve të akredituara;

- Të bashkëpunojë me DPS, DPMK, ministrinë e linjës dhe shoqatat e interesuara në çështje të akreditimit, si dhe me institucione të tjera private dhe publike, sipas nevojës, si në fushat vullnetare dhe në ato të rregulluara;

- Të sigurojë trajnim në lidhje me fushën e akreditimit;

- Të ndërmarrë aktivitete në fushën e krahasimeve ndërlaboratorike dhe testimit të efektivitetit;

- Të marrë informacion nga organet e akreditimit të vendeve të tjera në lidhje me organet e akredituara nga ta, që operojnë në Shqipëri.

- U vendos gjoba subjekteve të paakredituara, apo të cilave u ka mbaruar akreditimi, në rastet kur ato përdorin simbolin e akreditimit;

- I trajton ankesat dhe apelimet për akreditimin, të dërguara në Drejtorinë e Përgjithshme të Akreditimit.

v. Fusha e veprimt

Drejtoria e Akreditimit është e autorizuar të sigurojë shërbime akreditimi në fushat e mëposhtme:

- Laboratore testimi (duke përfshirë ato për analiza mjekësore);

- Laboratore kalibrimi;

- Organe çertifikimi të QMS;

- Organe të çertifikimit të produkteve;

- Organe të çertifikimit të personelit;

- Organet e inspektimit;

- Organizmave që realizojnë teste zotësie dhe krahasime ndërlaboratorike;

- Organizmave që prodhojnë materiale referuese të certifikuara.

vi. Organizimi dhe funksionimi

DPA ka një numër prej 14 punonjësish, 10 prej të cilëve janë përfshirë në procesin e akreditimit.


DPA është e organizuar në 4 departamente:

- Departamenti i Akreditimit;

- Departamenti i Zhvillimit;

- Sektori i Personelit dhe Burimeve Financiare;
- Sekretariati.

ORGANINOGRAMA E DA



Për më tepër, një Bord Këshillues funksionon pranë DPA (me vendim të Këshillit të Ministrave nr.854/19.12.2003 Mbi organizimin dhe funksionimin e Drejtorisë së Akreditimit). Ai përbëhet nga 11 anëtarë (shih Shtojcën 5) dhe drejtohet nga përfaqësuesi i METE-s. Detyrat e Bordit Këshillues janë të zhvillojë politika dhe strategji në lidhje me akreditimin; Bordi gjithashtu është përgjegjës për trajtimin e ankesave dhe apeliemeve të marra nga DPA.

DPA vendosi të krijojë 3 Komitete Teknike:

- Komiteti teknik për akreditimin e laboratoreve;
- Komiteti teknik për akreditimin e organeve të certifikimit;
- Komiteti teknik për akreditimin e organeve të inspektimit.

Komitetet teknike janë përfshirë në zhvillimin e dokumentave të nevojshme të akreditimit, duke dhënë këshillim në të gjitha çështjet teknike dhe mbështetjen e trajnimit të ekspertëve të DPA-së, të punësuar ose të kontraktuar.

DPA aktualisht funksionon në një ndërtesë shtetërore, për kohën në vazhdim zyrat janë të mjaftueshme dhe janë vënë në dispozicion pajisje minimale. Ende ka për t'u bërë për sa i përket pajisjeve.

DPA zhvillon dhe mirëmban një faqe interneti ku është publikuar i gjithë informacioni në lidhje me akreditimin.

vii. Sistemi i menaxhimit

DPA është e organizuar dhe funksionon sipas dispozitave të standardit të zbatueshëm të referencës EN ISO/IEC 17011:2004 Vlerësimi i konformitetit – Kërkesat e përgjithshme për organet e akreditimit që akreditojnë organe vlerësimi konformiteti.

Me mbështetjen e marrë në kuadër të projektit CARDS 2003, DPA ka zhvilluar dhe zbatuar një sistem menaxhimi në përputhje me standardin e lartpërmendur. Manuali i Cilësisë dhe të gjitha procedurat janë funksionale dhe të disponueshme në gjuhën angleze.

viii. Burimet Njerëzore

DPA ka miratuar një numër prej 15 pozicionesh, njëri prej tyre është ende bosh dhe pjesa tjetër e plotësuar. DPA drejtohet nga Drejtori i Përgjithshëm; Departamenti i Akreditimit ka një personel prej 7 ekspertësh, Departamenti i Zhvillimit ka 2 ekspertë, Sektori i Personelit dhe Burimeve Njerëzore ka 2 ekspertë dhe sekretariati ka një vend bosh.

I gjithë stafi është trajnuar në kuadër të programit CARDS 2003 dhe një pjesë e tyre edhe sipas programit CARDS 2001 dhe programit rajonal CARDS 2002. Duke marrë në konsideratë se akreditimi është një aktivitet që ka filluar vetëm kohët e fundit në Shqipëri dhe gjithashtu se mbështetet gjerësisht në kompetencën e vlerësuesve të përfshirë, trajnimi i mëtejshëm, më i specializuar dhe më i detajuar, është ende i nevojshëm. Gjithashtu, duhet mbajtur parasysh se ekspertët e akreditimit kanë nevojë të kenë një nivel të caktuar kompetence që duhet të rritet në mënyrë të përhershme ose të paktën të ruhet. Një prej metodave për ta arritur këtë është t'u japë rregullisht vlerësuesve trajnim të përhershëm. Nga kjo pikëpamje, duhet t'i jepet vëmendje e veçantë Departamenti i Zhvillimit si përsa i përket pajisjeve, ashtu edhe burimeve njerëzore.

I gjithë stafi i DPA ka njohuri të mira të gjuhës angleze dhe/ose italiane dhe gjithashtu aftësi të mira kompjuterike.

c.2. Infrastruktura e Vlerësimit të Konformitetit

Shumë prej OVP-s në Shqipëri, me disa përjashtime, e kanë origjinën nga regjimi komunist dhe janë të vjetëruara për sa i përket pajisjeve dhe procedurave të punës.

- Nuk ka laboratore kalibrimi përveç atyre të DPMK;

- Labororet e testimit, me përjashtimin e disa laboratoreve të reja dhe moderne (të akredituara ose në proces akreditimi) funksionojnë në ndërtesa të papërshtatshme dhe përdorin pajisje të vjetra dhe të amortizuara që nuk janë kalibruar në mënyrën e duhur;

- Në fushën e certifikimit të sistemeve të menaxhimit të cilësive ka një organ shqiptar certifikimi dhe disa organe të huaja. DPS, gjithashtu ka ofruar shërbime certifikimi, por ky aktivitet tashmë është pezulluar për shkak të një legjislacioni të ri, aktualisht në proces miratimi, që parashikon ndarjen e aktivitetit të certifikimit nga ai i standardizimit;

- Ka një organ të akredituar certifikimi produkteve për prodhimet ushqimore;

- Aktualisht nuk është krijuar asnjë organ certifikimi të sistemeve të menaxhimit të mjedisit;

- Funksionon një organ certifikimi personeli ndërsa ky aktivitet gjithashtu është pezulluar në DPS;

- Ka një numër organesh inspektimi që operojnë në Shqipëri në një situatë shumë të ngjashme me atë të laboratoreve të testimit; ende nuk është akredituar asnjë organ inspektimi.

Projekti CARDS 2003 ka ndërmarrë disa hapa për të mbështetur modernizimin e OVP shqiptare, por kapaciteti i tyre mbetet shumë i dobët. Ndërgjegjësimi është i ulët mes industrisë, konsumatorëve dhe madje autoriteteve publike në lidhje me çështjet e cilësisë, akreditimit ose standardizimit. Duke marrë parasysh edhe gjëndjen e dobët aktuale të ekonomisë që ende nuk kërkon shërbimet e ofruara nga OVP dhe përpjekjet e mëdha që nevojiten për të krijuar një infrastrukturë moderne dhe të besueshme vlerësimi pajtueshmërie, është e vështirë tashmë të propozohet një investim masiv në pajisje, me qëllim për ta realizuar këtë. Nëse marrim në konsideratë edhe rezultatet e vlerësimit të sistemit metrologjik të përmbushur nga eksperti i metrologjisë në projekt, duke vlerësuar se vetëm pas 5 vjetësh, metrologjia mund të pritët të fillojë të ketë besueshmërinë e kërkuar, konkluzioni i vetëm mund të jetë se është ende mjaft herët për një investim të tillë. Megjithatë, ndërkohë, duhet të merren masa për të rritur ndërgjegjësimin e përfituesve kryesorë të shërbimeve të dhëna nga OVP dhe të fillohet përgatitja e ekspertëve që kur është e nevojshme, janë të aftë të punojnë në infrastrukturën e OVPs.

I. VIZIONI, QELLIMI STRATEGJIK DHE PRIORITETET

VIZIONI

Ky kre përmbledh gjëndjen e Sistemit shqiptar të IC që do të jetë në fund të vitit 2022, nëse objektivat specifike të zhvillimit do të arrihen me anë të implementimit të masave specifike.

- Sistemi IC në Shqipëri do përmirësohet ndjeshëm deri në vitin 2022 dhe është tërësisht në përputhje me kërkesat e BE-së.

- Ka njohje të plotë ndërkombëtare në të gjitha fushat.

- Sistemi shqiptar IC klasifikohet si një nga më të mirët në rajon.

- Të gjitha standardet e referimit të matjeve egzistojnë për matjet e bëra.

- Aktiviteti i kalibrimit është zhvilluar plotësisht. Ka klientë nga vendet fqinje.

- Aktiviteti i testimit po rritet me hapa të shpejtë dhe shumë laboratore

(universitete, fabrika, organizata të tjera publike) marrin pjesë në aktivitete të integruara testimi.

- Objekti i verifikimit ligjor të instrumentave matëse ka arritur një nivel të kënaqshëm.

- Mekanizmi i miratimit tip është tërësisht funksional.

- Mbikqyrja metrologjike është zhvilluar plotësisht.

Më poshtë jepet përmbledhja e gjëndjes së Sistemit IC në fund të vitit 2022.

Fusha	Pajtueshmëria Ndërkombëtare	Probleme
Rregullat teknike	E plotë	Nuk ka
Mbikqyrja e tregut	E plotë	Nuk ka
Standardizimi	E plotë	Nuk ka
Metrologjia		
Standardet Kombëtare	E plotë	Nuk ka
Kalibrimi	E plotë	Nuk ka

Verifikimi	E plotë	Të vogla
Testimi	E plotë	Nuk ka
Miratimi tip	E plotë	Nuk ka
Mbikqyrja metrologjike	E plotë	Nuk ka
Akreditimi	E plotë	Nuk ka
Çertifikimi	E plotë	Të vogla
Markimi (psh. CE)	E plotë	Të vogla
Bashkërendimi dhe Monitorimi	E plotë	Të vogla

PRIORITETET AFATGJATE

Ky është përshkrimi i një sistemi tërësisht të pajtueshëm në nivel ndërkombëtar që Shqipëria duhet të arrijë brenda një periudhe prej 15 vjetësh.

a) Rregullat teknike dhe Standardizimi

Legjislacioni teknik i BE-së (si direktivat e përafrimit të ri dhe të vjetër dhe ato të reja përafruese) është transpozuar tërësisht në legjislacionin kombëtar shqiptar.

Procesi i shqyrtimit të këtij legjislacioni është i vazhdueshëm.

DPS është anëtare aktive e CEN dhe CENELEC

b) Metrologjia

i) Standardet Kombëtare të Matjeve

Standardet kombëtare në të 60 fusha e matjeve. Të gjitha të njohura nga EUROMET dhe të listuara në bazën elektronike të të dhënave CIPM/MRA.

ii) Funksionet e Institutit të Metrologjisë

Është krijuar dhe funksionon një Institut autonom Metrologjie pranë DPMK

(ne kete material do emertohet si Instituti Kombëtar Shqiptar i Metrologjisë dhe shkurtimisht ANMI).

Operacional në dy ndërtesa të reja që do përfundohen në 2010 dhe 2018.

Kontrolle të plota profesionale mjedisore.

Një prej instituteve kryesuese metrologjike në rajon.

Aftësi të plota matjeje në 60 fusha matjesh. Të gjitha matjet zhvillohen në Institutin e Metrologjisë (ANMI).

Asnjë kapacitet në 56 fusha matjesh të përshtatshme për ekonomitë e mesme.

Egziston një Strategji IC e mirëpërgatitur për periudhën 2023-2037 për zhvillimin e mëtejshëm të sistemit të metrologjisë në Shqipëri.

Laboraret janë tërësisht të akredituara.

Gjurmueshmëria është e vendosur në mënyrën e duhur dhe e pranuar nga EUROMET dhe BIPM.

Sistemi i cilësisë është implementuar në mënyrë të plotë.

Laboraret variojnë midis atyre parësorë mesatarë dhe dytësorë të lartë.

Krahasimet bëhen në të gjitha fushat e matjeve.

I gjithë stafi ka trajnimin e nevojshëm.

Staf i përshtatshëm, kompetent është punësuar dhe trajnuar.

Funksionojnë repartet e riparimit të mirembajtjes së pajisjeve elektronike dhe mekanike. Ka plane për hapjen edhe në mirembajtjen dhe riparimet në fushën optike.

Mund të riparohet një sasi të konsiderueshme të pajisjeve të matjeve, jo vetëm për Sistemin DPMK, por dhe për të gjithë laboratorët në Shqipëri.

Prodhon një numër të vogël pajisjesh dhe sistemesh të reja matjeje.

Bibliotekë e krijuar dhe mirëmbajtur siç duhet dhe infrastrukturë e teknologjisë së informacionit.

Kryen të gjitha krahasimet e nevojshme për laboraret e tjera në Shqipëri, siç kërkohet nga DPA.

Të gjithë kërkuesit (51) kanë trajnimin dhe çertifikimin e duhur për akreditim.

Sigurohen trajnime të rregullta për industrinë.

Është formuluar dhe funksionon një mekanizëm i plotë i fidbekut për klientin.

Funksionet e plota të bashkërendimit kombëtar jo vetëm të dhëna nga ligji i ri por në çdo fushë të infrastrukturës së matjeve, përmbushen nga DPMK.

Njohje e plotë ndërkombëtare nga EUROMET, WELMEC, EURACHEM, BIPM, OIML, IMEKO dhe EUROLAB.

ALBLAB është krijuar duke patur rreth 50 laboratore anëtare dhe që përfaqësojnë Shqipërinë në EUROLAB.

Shqipëria merr pjesë në Programin Kuadër BE dhe ANMI merr pjesë në të paktën një projekt të BE-së.

iii. Kalibrimi

Bëhen rreth 300 Kalibrime në 60 fusha në vit nga ANMI.

Të paktën 4 laboratore të akredituara kalibrimi në Shqipëri sigurojnë shërbime kalibrimi për laboraret testuese dhe prodhimin industrial.

iv. Infrastruktura e testimit

Rritje e numrit të testimeve në ANMI (siguria elektrike, mjedisore, kimike, materiale).

24 Laboratore të akredituara të testimit në Ushqim/mikrobiologji

Mjedis

Shëndetësi/Mjekësi

Teste elektrike

Teste mekanike

Ndërtim

Kimikate

Prodhime naftë

Tekstile

Lëndë plasëse

v. Laboratore të specializuara

Të akredituara:

Ushqimi (Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit)

Veterinaria (Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit)

Referenca Shëndetësore (Ministria e Shëndetësisë)

Referenca e Mbrojtjes Mjedisore (Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujrave)

Referenca Mjekoligjore (Ministria e Drejtësisë)

Kontrolli i dopingut (Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve)

Testimi i materialeve (METE)

Ndërtimi (METE)

Telekomunikacioni (Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit)

vi. Verifikimi

Laboratori qendror i Tiranës në godinën egzistuese të DPMK.

Qendrat rajonale në Fier, Lezhë, Korçë.

Asnjë zyrë në rrethe. Mjedise të lëvizshme të bazuara në katër qendra të shërbejnë rretheve.

2 laboratore private të akredituara që kryejnë verifikimin.

Aftësi matjesh në të gjitha zonat e përcaktuara në ligjin e ri.

vii. Miratimi tip

Aftësi e kufizuar. Përdor çertifikata testimesh të nxjerra nga qendrat e akredituara të testimit dhe organizatat e huaja të njohura nga DPA. Miratimi tip është dhënë nga DPMK duke përdorur çertifikatat e testimit të jashtëm.

viii. Mbikqyrja metrologjike

Personel prej 20 vetash.

Tepër i lëvizshëm, përdoret bashkë me metrologjinë ligjore dhe ANMI.

Aktive në të gjitha fushat e përcaktuara nga ligji i ri.

Punë nënkontratash në universitete, inspektim privat dhe organizata të tjera, me kusht që ato të kenë akreditimin e duhur.

c. Vlerësimi i Konformitetit dhe Akreditimi

c.1. Akreditimi

Sistemi i akreditimit do të jetë i mirëkrijuar dhe do të gëzojë njohje të plotë europiane dhe ndërkombëtare. DPA do të jetë nënshkruese për të gjitha fushat e veprimit të EA/MLA dhe gjithashtu të ILAC dhe IAF MRAs. Do të miratohet legjislacioni evropian dhe DPA do të kryejë akreditimin e organeve që duhen caktuar për të operuar në fushën e rregulluar.

c.2. Infrastruktura e vlerësimit të konformitetit

Infrastruktura e vlerësimit të pajtueshmërisë do të jetë e mjaftueshme që t'i shërbejë në nivelin e duhur ekonomisë shqiptare. OVP-s do të akreditohen. Si pasojë e DPA si nënshkruese në EA MLAs, këto do të përfitojnë nga njohja europiane dhe ndërkombëtare duke nënkuptuar se çertifikatat dhe raportet e testimit/kalibrimit do të pranohen në të gjitha vendet, duke patur gjithashtu një organizëm akreditues nënshkrues MLA. Shqipëria do të jetë nënshkruese në ACAA për të paktën dy kategori produktesh.

Prioritetet për vitin 2008

Ky kre është një përmbledhje e vlerësimit të gjëndjes egzistuese të sistemit IC.

- Aktualisht Sistemi IC në Shqipëri nuk është i pajtueshëm me kërkesat e BE-së.

- Nuk ka pothuajse asnjë njohje ndërkombëtare për ndonjë prej komponentëve të Sistemit IC.

- Aktualisht Shqipëria ka një prej Sistemeve IC më pak të zhvilluara në rajon.

- Ka vetëm disa standarde të detyrueshme, pavarësisht nga mungesa e legjislacionit të produkteve të detyrueshme.

- Procesi i përafrimit të legjislacionit teknik ka filluar. Legjislacioni horizontal është funksional.

- Ndikimi i rregulloreve në treg nuk është vlerësuar në mënyrën e duhur.
 - Inspektimi dhe Sistemi i mbikqyrjes së tregut është pothuajse inegzistent.
 - Nuk ka asnjë standard kombëtar referimi matjesh.
 - Nuk ka pothuajse asnjë aktivitet kalibrimi.
 - Ka një aktivitet mjaft të kufizuar testimi.
 - Objekti i verifikimit të instrumentave të matjeve është mjaft i kufizuar.
 - Nuk ka asnjë mekanizëm miratimi tip.
 - Sapo ka filluar mbikqyrja metrologjike.
 - Nuk ka laboratore të akredituara kalibrimi.
 - Ka disa laboratore të akredituara testimi.
 - Pritet të bëhet progres në nivel të ulët gjatë 3 viteve të ardhshme, meqë akreditimi, testimi, çertifikimi i produkteve dhe inspektimi varen gjerësisht në infrastrukturën metrologjike.
 - DA organizohet dhe operon sipas kërkesave të EA, përveç aspekteve metrologjike.
- Më poshtë jepet një përmbledhje e gjëndjes së Sistemit të IC-se në vitin 2008.

Fusha	Pajtueshmëria ndërkombëtare	Probleme
Rregullat teknike	Nuk ka	Serioze
Mbikqyrja e tregut	Nuk ka	Serioze
Standardizimi	Nuk ka	Serioze
Metrologjia		
Standardet kombëtare	Nuk ka	Serioze
Kalibrimi	Nuk ka	Serioze
Verifikimi	E pjesshme	Serioze
Testimi	Nuk ka	Serioze
Miratimi tip	Nuk ka	Serioze
Mbikqyrja metrologjike	Nuk ka	Serioze
Akreditimi	E pjesshme	Serioze
Çertifikimi	Nuk ka	Serioze
Markimi (psh. CE)	Nuk ka	Serioze
Bashkërendimi dhe Monitorimi	Nuk ka	Madhore

Prioritetet 2008 - 2012

Ky kre përmbledh gjëndjen e Sistemit Shqiptar të IC që do të jetë deri në fund të vitit 2012, nëse objektivat specifike të zhvillimit do të arrihen me anë të implementimit të masave specifike.

- Sistemi IC në Shqipëri do përmirësohet ndjeshëm deri në vitin 2012, por ende jo tërësisht në përputhje me kërkesat e BE-së.

- Ka njohje të kufizuar ndërkombëtare për disa zona.
 - Shqipëria ka ende Sistemin IC më pak të zhvilluar në rajon, veçanërisht në zonën e metrologjisë.
 - Shumë prej direktivave të reja përfruese janë transpozuar në legjislacionin kombëtar
 - Vëzhgimi dhe inspektimi i tregut po ecin me hapa të mirë
 - DPS plotëson të gjitha kushtet për t'u bërë anëtare e CEN dhe CENELEC
 - Rëndësia e standardizimit në lidhje me legjislacionin dhe cilësinë e produkteve, është e njohur
 - Ka një numër të kufizuar standardesh kombëtare të referimit të matjeve.
 - Ka filluar aktiviteti i kalibrimit por ka ende nevojë për përmirësim të konsiderueshëm.
 - Aktiviteti i testimit po rritet me hapa të shpejtë.
 - Objekti i verifikimit ligjor të instrumentave të matjeve është përmirësuar ndjeshëm.
 - Mekanizmi i miratimit tip është ende mjaft i kufizuar.
 - Mbikqyrja metrologjike po ecën me hapa të shpejtë.
 - Akreditimi siguron shërbime kompetente, duke përfshirë në disa fusha të reja (laboraret mjekësore, çertifikimi i shendetit dhe sigurisë në punë dhe i sistemeve të menaxhimit të mjedisit) dhe fillon fusha të reja akreditimi (organizatorët e testeve të zotesisë (PT) dhe prodhuesit e Materialeve referuese të çertifikuara)
 - DPA fillon përgatitjen për të akredituar në fushën e rregulluar
- Më poshtë jepet një përmbledhje e gjëndjes së Sistemit shqiptar të IC deri në fund të vitit 2012.

Fusha	Pajtueshmëria ndërkombëtare	Probleme
Rregullat teknike	E pjesshme	Mesatare
Mbikqyrja e tregut	E pjesshme	Mesatare
Standardizimi	E plotë	Nuk ka
Metrologjia		

Standardet kombëtare	E pjesshme	Mesatare
Kalibrimi	E pjesshme	Mesatare
Verifikimi	E pjesshme	Mesatare
Testimi	Nuk ka	Madhore
Miratimi tip	Nuk ka	Madhore
Mbikqyrja metrologjike	E pjesshme	Mesatare
Akreditimi	E pjesshme	Mesatare
Çertifikimi	E pjesshme	Mesatare
Markimi (psh. CE)	E pjesshme	Mesatare
Bashkërendimi dhe monitorimi	E pjesshme	Mesatare

Prioritetet 2013 - 2017

Ky kapitull përmbledh gjëndjen e Sistemit IC , që do të jetë deri në fund të vitit 2017, nëse objektiva specifike zhvillimit arrihen me anë të implementimit të masave specifike.

- Sistemi IC në Shqipëri do përmirësohet ndjeshëm deri në vitin 2017, dhe është pjesërisht në përputhje me kërkesat e BE-së, veçanërisht në fushat e standardizimit dhe akreditimit.

- Ka njohje të plotë ndërkombëtare për disa zona.

- Sistemi IC në Shqipëri klasifikohet mesatar mes vendeve në rajon.

- Numri i standardeve kombëtare të referimit të matjeve ka arritur një nivel të kënaqshëm por ende ka nevojë për përmirësim.

- Aktiviteti i kalibrimit është përmirësuar por ende nuk është i mjaftueshëm në numër.

- Aktiviteti i testimit ka mbuluar shumë fusha të reja dhe po rritet me hapa të shpejtë.

- Objekti i verifikimit ligjor të instrumentave matëse është përmirësuar ndjeshëm dhe mbulon pothuajse të gjitha fushat e përmendura në ligj.

- Mekanizmi i miratimit tipit është përmirësuar ndjeshëm, pasi DPMK ka filluar të pranojë raportet e testeve nga laboratorët e akredituar për të nxjerrë miratime tip.

- Mbikqyrja metrologjike është zhvilluar plotësisht.

- Akreditimi është në gjëndje të sigurojë shërbime të besueshme në të gjitha fushat e kërkuara nga ekonomia shqiptare.

- Akreditimi ka arritur njohjen në nivel evropian dhe ndërkombëtar

- Akreditimi dhe vlerësimi i pajtueshmërisë në fushën e rregulluar, janë funksionale

- Është prezantuar Markimi CE.

Më poshtë jepet një përmbledhje e gjëndjes së Sistemit shqiptar IC në fund të vitit 2017.

Fusha	Pajtueshmëria Ndërkombëtare	Probleme
Rregullat teknike	E pjesshme	Të vogla
Mbikqyrja e tregut	E pjesshme	Të vogla
Standardizimi	E plotë	Nuk ka
Metrologjia		
Standardet kombëtare	E plotë	Të vogla
Kalibrimi	E plotë	Të vogla
Verifikimi	E pjesshme	Mesatare
Testimi	E pjesshme	Mesatare
Miratimi tip	E plotë	Të vogla
Mbikqyrja metrologjike	E plotë	Të vogla
Akreditimi	E plotë	Të vogla
Çertifikimi	E pjesshme	Të vogla
Markimi (p.sh. CE)	E pjesshme	Të vogla
Bashkërendimi dhe monitorimi	E pjesshme	Të vogla

Prioritetet 2018 – 2022

Ky kre përmbledh gjëndjen e Sistemit shqiptar të IC për periudhën 2018 - 2022, nëse objektivat specifike të zhvillimit do të arrihen me anë të implementimit të masave specifike.

- Sistemi IC në Shqipëri do përmirësohet ndjeshëm deri në vitin 2022 dhe është tërësisht në përputhje me kërkesat e BE-së.

- Ka njohje të plotë ndërkombëtare në të gjitha fushat.

- Sistemi shqiptar IC klasifikohet si një nga më të mirët në rajon.

- Të gjitha standardet e referimit të matjeve egzistojnë për matjet e bëra.

- Aktiviteti i kalibrimit është zhvilluar plotësisht. Ka klientë nga vendet fqinje.

- Aktiviteti i testimit po rritet me hapa të shpejtë dhe shumë laboratore

(universitete, fabrika, organizata të tjera publike) marrin pjesë në aktivitete të integruara testimi.

- Objekti i verifikimit ligjor të instrumentave matëse ka arritur një nivel të kënaqshëm.

- Mekanizmi i miratimit tip është tërësisht funksional.
 - Mbikqyrja metrologjike është zhvilluar plotësisht.
- Më poshtë jepet përmbledhja e gjëndjes së Sistemit IC në fund të vitit 2022.

Fusha	Pajtuueshmëria Ndërkombëtare	Probleme
Rregullat teknike	E plotë	Nuk ka
Mbikqyrja e tregut	E plotë	Nuk ka
Standardizimi	E plotë	Nuk ka
Metrologjia		
Standardet Kombëtare	E plotë	Nuk ka
Kalibrimi	E plotë	Nuk ka
Verifikimi	E plotë	Të vogla
Testimi	E plotë	Nuk ka
Miratimi tip	E plotë	Nuk ka
Mbikqyrja metrologjike	E plotë	Nuk ka
Akreditimi	E plotë	Nuk ka
Çertifikimi	E plotë	Të vogla
Markimi (psh. CE)	E plotë	Të vogla
Bashkërendimi dhe Monitorimi	E plotë	Të vogla

I POLITIKA E PERGJITHSHME

Në Shqipëri, proceset e Standardizimit mund të konsiderohen të pavarur nga ato të Akreditimit dhe Metrologjisë. Ka një forcë kryesore shtytëse për Standardizimin, kjo është kërkesa lokale (duke përfshirë vullnetin për integrimin në Europë dhe në botën e zhvilluar). Nga ana tjetër, akreditimi varet nga kërkesa lokale dhe disponueshmëria e shërbimeve të ngjashme të metrologjisë. Kështu, ka dy parametra të rëndësishëm për zhvillimin e Akreditimit. Për metrologjinë ka katër parametra kryesore: nevojat ekonomike (kërkesat e klientëve nëse ata dëshirojnë të akreditohen apo jo), nevojat rregullatore për infrastrukturën e matjeve (nevojat e vendosura në fuqi nga organet rregullatore për shkak të inspektimit, vëzhgimit dhe kontrollit të tregut, akreditimit, shëndetit, mjedisit, kontrollit të krimit, monitorimit të lojrave të fatit etj), kërkesat ndërkombëtare (për matjet shqiptare që të njihen në nivel ndërkombëtar) dhe kërkesat e gjurmueshmërisë (kryesisht për shkak të kërkesave të brendshme për gjurmueshmërinë). Ka një mbivendosje të fuqishme për disa kërkesa për Akreditimin dhe Metrologjinë. Kjo është gjurmueshmëria dhe kërkesat e testimit të krahasimit/efektivitetit të laboratoreve të akredituara.

Strategjia e përgjithshme është e fokusuar në dy aspekte.

- Zhvillimi sa më i shpejtë i standardizimit, pa marrë në konsideratë dy fushat e tjera.
- Zhvillimi i metrologjisë, duke analizuar kërkesat e Akreditimit. Nga ana tjetër, përcaktimi i kërkesave të Akreditimit, duke përcaktuar nevojat për pjesën e akredituar të infrastrukturës së matjeve.

Zhvillimi i Standardizimit është mjaft i drejtpërdrejtë dhe nuk varet nga shumë parametra.

Megjithatë, ndërvarësia e Metrologjisë/Akreditimit e bën mjaft të ndërlikuar përgatitjen e një Strategjie praktike. Problemi kryesor është koha e kërkuar për zhvillimin e sistemit të metrologjisë. Normalisht, do të jetë pas rreth 15 vjetësh por kjo vendos mjaft kufizime mbi Akreditimin meqë pjesa kryesore e kërkesës është për akreditimin e laboratoreve.

Zhvillimi normal i sistemit të metrologjisë kërkon një investim 15 vjeçar, I cili përfshin ndërtimin e dy ndërtesave, blerjen e paisjeve të reja si dhe trainimi I stafit.

Kërkesat e Akreditimit kanë peshën më të madhe dhe zonat që duhen zhvilluar janë përzgjedhur për t'i siguruar shërbime sa më shumë laboratoreve të testimit që të jetë e mundur. Në bazë të kësaj arsyeje, laboratorët e qëllimit të përgjithshëm si masa, presioni, temperatura dhe energjia, kanë prioritet më të lartë për zhvillim sesa laboratorët e specializuara si akustika, optika, dhe mikrovala.

Një vendim i rëndësishëm, ka lidhje me matjet e rrezatimit jonizues dhe elektrik. Këto dy grupe matjesh kryhen jashtë DPMK për kohën në vazhdim. Rrezatimi jonizues kërkon ndërtesë të specializuar dhe masa të posaçme për matje. Mund të jetë një ide e mirë të ruhet sistemi egzistues për të ardhmen. Megjithatë, kjo kërkon një mënyrë formale të matjeve, një sistem shumë të mirë menaxhimi cilësie, paraqitjen rregullisht të gjëndjes së matjeve në organizatat ndërkombëtare të metrologjisë etj. Që të dyja janë të kushtueshme dhe kërkojnë kohë. Operacionet egzistuese gjithashtu kanë nevojë të zgjerohen si për sa i përket pajisjeve, edhe stafit të ri. Nuk është e qartë nëse këto mund të materializohen në një mjedis të ngjashëm me universitetin. Kjo duhet të diskutohet dhe vendimi mbi të ardhmen e rrezatimit jonizues në Shqipëri duhet të përcaktohet para se të projektohen laboratorët e specializuara (afërsisht para vitit 2017).

Për matjet elektrike, vendimi është mjaft i lehtë. Për kohën në vazhdim, vetëm një pjesë e vogël e asaj çfarë nevojitet, kryhet në universitet. Nuk do të ketë pothuajse asnjë kursim, nëse lihet në universitet. Është më mirë të jetë një grup i plotë matjesh në një vend meqë ndërvarësia midis matjeve elektrike dhe pjesës të tjera të

metrologjisë, është mjaft e fuqishme. Të gjitha pajisjet elektrike të përdorura në fushat e tjera kanë nevojë të kalibrohen nga laboratorit elektrik dhe rezistencat, termometrat, matësit e lagështisë të përdorur nga laboratorit elektrik duhet të kalibrohen rregullisht nga laboratorit tjetër. Në një fazë më të avancuar, laboratorit elektrik gjithashtu ka nevojë për matje dimensionale, mase dhe presioni. Kështu, kjo Strategji sugjeron se të gjitha matjet elektrike duhet të trajtohen në nivel kombëtar nga DPMK dhe infrastruktura egzistuese në universitet duhet të zhvillohet si një laborator i akredituar kalibrimi në fushën e matjeve elektrike.

Objektivat specifike (2008-2012)

Ky kre përmbledh objektivat specifike të zhvillimit për periudhën 5 vjeçare (2008-2012).

Rregullat Teknike dhe Standardizimi

METE ka transpozuar direktivat e mëposhtme:

Data e synuar	Versioni përfundimtar i directives	Subjekti (titulli i shkurtër i direktivës)
2008	94/9/EC	Atmosferat eksplozive të pajisjeve (ATEX)
2008	94/62/EC	Ambalazhi dhe mbetjet e ambalazhimit
2008	96/57/EC	Kërkesat e efikasitetit të energjisë për frigoriferët elektrikë shtëpiakë, ngrirësit dhe kombinimet e tyre
2008	73/404/EEC, 73/405/EEC, 82/242/EEC, 82/243/EEC	Detergjentët
2008	2002/96/EC	Pajisje mbetjesh elektrike dhe elektronike (WEEE)
2008 – 2009	98/37/EC	Makinieri
2008 – 2009	95/16/EC	Ashensorë
2009	89/686/EEC	Pajisje personale mbrojtëse (PPE)
2009	90/396/EEC	Pajisje që djegin karburante të gazta
2009	92/42/EEC	Kërkesat e efikasitetit të energjisë për bojërat të reja me ujë të ngrohtë që ndizen me karburant të lëngshëm ose të gaztë
2009		Druri
2009	96/74/EEC, 97/73/EEC, 73/44/EEC	Tekstile
2009	99/411/EEC	Këpucë
2009	64/493/EEC	Qelqurina
2010	2000/9/EC	Instalimet e teleferikut me shina, të projektuara për transportimin e personave
2010	1999/36/EC	Pajisje me presion të transportueshme
	2000/55/EC	Kërkesat e efikasitetit të energjisë për balastet për ndriçimin fluoreshent
	92/75/EC	Etiketimi i energjisë në pajisjet elektroshtëpiake
DPMK 2007 - 2008	90/384/EEC	Instrumenta peshuese jo automatike
DPMK 2007 - 2008	2004/22/EC	Instrumenta matëse

DPS pajtohet me kërkesat për t'u bërë anëtare e CEN dhe CENELEC:

Siç u deklarua më parë, Kushtet 1,2 (a) dhe 2 (b) nuk janë nën përgjegjësinë e menjëhershme të DPS, por të qeverisë.

Kushti 2(c)

Ka zbatim të plotë në Shqipëri të paktën të asaj pjese të Direktivës 98/34/EC të amenduar nga direktiva 98/48/EC, në lidhje me aktivitetet e standardizimit.

Kushti 3 (a)

Do të jepen prova me qëllim që DPS të njihet në Shqipëri si organi zyrtar i standardeve, kompetent për

të gjitha fushat e CEN's dhe fushat e kompetencës së vetë CENELEC (që mbulon të gjithë sektorët ekonomikë, përveç atyre të mbuluar nga ETSI).

Kushti 3 (b)

Rregullat e brendshme të zbatueshme për DPS duhet të jenë tërësisht në pajtim me mënyrën e organizimit të standardizimit vullnetar, siç operohet në CEN/CENELEC.

Kushti 4

Për arsye të dukshme të pavarësisë dhe trajtimit të drejtë në lidhje me antarët e tjerë CEN/CENELEC, DPS do të duhet të paguajë kuotat e saj kombëtare të anëtarësimit, kur të pranohet si antare me të drejta të plota e CEN/CENELEC. Kuota korresponduese do të ishte e pagueshme nga 1 janari, pas pranimi të DPS si antare me të drejta të plota.

Kushti 5

Një prej detyrimeve kryesore të DPS do të jetë të transmetojë pikëpamjen kombëtare mbi çështjet teknike si mbi çështje formale (vota, kërkimi...). DPS do të duhet të mbështesë mbi 2000 procese formale në vit që kërkojnë dukshëm mjete, kompetencë dhe ekspertizë në nivel kombëtar. Për më tepër, DPS do të pritët të kontribuojë me ekspertizë ndaj KT për të cilat ekonomia shqiptare është aktive. Në atë drejtim, DPS do të duhet të japë prova të aftësisë së saj për të trajtuar efektivisht këto çështje. Si element i provës, të dhënat e DPS kur marrin pjesë si antare pa të drejta vote në punën teknike, duhen marrë në konsideratë. Pjesëmarrja e DPS në KT/NKT/GP në lidhje me numrin e ekspertëve, është një element i rëndësishëm i cili, megjithatë, duhet të vlerësohet në lidhje me zhvillimin ekonomik të Shqipërisë. Gjithashtu, duhet marrë në konsideratë "cilësia" (pasive-aktive) e kësaj pjesëmarrjeje.

Kushti 6

Për sa i përket pjesëmarrjes formale në proceset CEN/CENELEC, është e nevojshme për DPS që të jetë në zotërim të paisjeve operacionale të telekomunikacionit (duke përfshirë email-in dhe Internetin) dhe infrastrukturën e teknologjisë së informacionit, duke e lejuar atë t'i përgjigjet efektivisht volumit të madh të të dhënave dhe dokumentacionit, të komunikimit brenda sistemit CEN/CENELEC dhe të marrë pjesë në procesin e votimit (votimi elektronik).

Kushti 7

Një mision thelbësor i DPS është implementimi i EN, që përcaktohet në Rregullat e Brendshme të CEN/CENELEC IR, Pjesa 2 dhe klauzola 5.2. Ky implementim është një operacion në dy faza: t'i japë EN statusin e Standardeve kombëtare shqiptare dhe shfuqizimi i ndonjë dokumenti konfliktual. Një prej elementeve që duhet marrë në konsideratë kur vendoset mbi aplikimin e DPS's, janë të dhënat e saj në zbatimin e EN's që tashmë janë miratuar nga CEN/CENELEC ("legjislacioni" CEN/CENELEC). Për sa i përket shfuqizimit të dokumentave kombëtare konfliktuale në Shqipëri, është bërë pjesërisht dhe, për këtë shfuqizim duhet të hartohet nga DPS një grafik i saktë me afate të arsyeshme kohore. 80% e implementimeve duhet të jenë bërë para hyrjes së DPS si anëtare me të drejta të plota. Duhet të propozohet një grafik i arsyeshëm për pjesën që mbetet të implementimit dhe shfuqizimit të dokumentave konfliktuale që mbeten.

Kushti 8

Në përputhje me rregullat egzistuese CEN/CENELEC, DPS duhet të përgatitet në procedurën e notifikimit për punët në nivel kombëtar që përfshin një "ndalesë" në të gjithë punëve në nivel kombëtar për fushat e punës europiane të rëna dakord. Do të sigurohen prova të Rregullave të Brendshme korresponduese të DPS.

Kushti 9

DPS duhet të paraqesë prova se politika e CEN/CENELEC mbi të drejtat e autorit dhe të drejtat e shfrytëzimit, siç jepen në Marrëveshjen e Shfrytëzimit, mund të zbatohen në mënyrën e duhur në Shqipëri, duke marrë parasysh legjislacionin aktual (ose të planifikuar) kombëtar mbi mbrojtjen e të drejtave të pronësisë intelektuale. Më tej, DPS duhet të tregojë se politika e saj tregtare është në përputhje me klauzolat dhe dispozitat e Udhëzimit 10 CEN/CENELEC që vendos politikën e rënë dakord për shpërndarjen dhe shitjen e publikimeve CEN/CENELEC.

b. Metrologjia

i. Standardet Kombëtare të Matjeve

1. Për të patur standarde kombëtare të vendosura siç duhet dhe të ruajtura në të 33 fushat e matjeve.

ii. Funkcionet e Institutit të Metrologjisë

2. Të krijojë një Institut autonom Metrologjie (ANMI) pranë DPMK që ka fleksibilitet në zhvillimin e burimeve njerëzore (veçanërisht punësimi, performanca e bazuar në ngritjen në detyrë dhe trajnim) dhe përdorimi i të ardhurave të veta pa kufizime.

3. Të përmirësojë ndërtesën egzistuese në mënyrë që të bëhen disa investime derisa të jetë gati ndërtesa e re.

4. Të përfundojë dhe transferohet në ndërtesën e re që ka të paktën 1300 m² hapësirë laboratorike me kontroll të plotë mjedisor për labororet e metrologjisë.

5. Të krijojë 18 fusha të reja matjesh duke e çuar numrin total të fushave operacionale të matjeve në 33.

6. Të punësojë, trajnojë anëtarë të rinj stafi, në mënyrë që deri nga fundi i vitit 2012, DPMK të ketë një personel prej 128 vetash, 34 prej të cilëve janë kërkues.
7. Të përditësojë kete Strategji te IC në mënyrë që të vazhdojë të mbulojë 15 vitet e ardhshme të zhvillimit.
8. Të akreditojë të paktën 25 prej 33 fushave të matjeve ku ANMI do të jetë aktive.
9. Të vendosë gjurmueshmëri në mënyrën e duhur në të 33 fushat e matjeve.
10. Të ketë të paktën 25 prej 33 fushat e matjeve, të njohura nga EUROMET dhe BIPM.
11. Të implementojë në mënyrë të plotë Sistemin e Cilësisë.
12. Të sigurojë që të gjitha labororet të jenë të paktën në nivelin “Dytësore Mesatare”.
13. Të ketë të paktën tre laborore në nivelin “Parësore të Ulët”.
14. Të marrë pjesë në krahasime për të paktën 25 prej 33 fushave të matjeve.
15. Të trajnojë në nivelin e duhur të 34 kërkuesit që punojnë pranë ANMI-t.
16. Të hartojë dhe implementojë një program të zhvillimit të burimeve njerëzore.
17. Të krijojë një repart për riparime e mirembajtje te pajisjeve elektronike në ndërtesën e re.
18. Të krijojë një bibliotekë në ndërtesën e re me të paktën 100 libra në metrologji dhe abonim në të paktën 20 gazeta shkencore.
19. Të krijojë një Sistem modern teknologjie informacioni pranë DPMK dhe të ketë të paktën gjysmën e shpërndarjes së informacionit të brendshëm në formë elektronike.
20. Të krijojë një faqe interneti interactive, në mënyrë që aplikimi për shërbimet DPMK të mund të bëhet me anë të internetit dhe klientët të mund të ndjekin ecurinë e shërbimeve për të cilat paguajnë.
21. Të sigurojë trajnime të rregullta për industrinë në të paktën 10 fusha matje, duke përfshirë metrologjinë e përgjithshme dhe vlerësimin e pasaktësisë.
22. Të përgatisë dhe implementojë një mekanizëm fidbeku të klientit, në mënyrë që DPMK ta dijë se çfarë mendojnë klientët e saj në lidhje me operacionet dhe shërbimet DPMK (klientët përfshijnë klientët e brendshëm si dhe të gjithë aktorët e tjerë).
23. Të drejtojë një fushatë për rritjen e ndërgjegjësimit publik.
24. Ta bëjë DPMK koordinator kombëtar për të gjithë infrastrukturën metrologjike jo vetëm në letër, por edhe praktikisht.
25. Të bëhet Anëtare e Konventës së Metrologjisë (nga Shqipëria), dhe të nënshkruajë CIPM/MRA (nga DPMK).
26. Të bëhet anëtare e EURACHEM.
27. Të rrisë ndërveprimet me WELMEC.
28. Të krijojë ALBLAB (Organizatën e Laboratoreve Shqiptare të Matjeve) për t’u bërë pjesë e EUROLAB-it.
29. Të marrë pjesë në të gjitha komitetet teknike të EUROMET-t dhe në disa komitete teknike të IMEKO-s.
30. Të organizojë të pakën një takim komiteti teknik EUROMET në Tiranë.
31. Të publikojë të paktën një dokument shkencor dhe të zhvillojë një diskutim shkencor në të paktën dy takime ndërkombëtare.
- iii. Kalibrimi
32. Të arrijë të paktën 50 Kalibrime në vit deri në fund të afatit në 33 fusha matjesh.
33. Të ndihmojë industrinë dhe DPA të kenë të paktën një laborator të akredituar kalibrimi (jashtë sistemit DPMK).
- iv. Infrastruktura e testimit
34. Të fillojë sasinë modeste të testimit në ANMI (siguria elektrike, mjedisore, kimike, materiale).
35. Të ndihmojë industrinë dhe DPA të kenë të paktën 12 Laborore Testimi të Akredituara në
Ushqim/mikrobiologji
Mjedis
Teste elektrike
Ndërtim
Produkte kimike/nafte
Lëndë plasëse
- v. Laborore të specializuara
36. Të përmirësojë operacionet e laboratoreve egzistuese Ushqimore dhe Veterinare, në mënyrë që të operojnë si laborore referimi në fushat e tyre dhe t’i akreditojnë ato.
37. Të krijojë Laborator Referimi në Shëndetësi (ndoshta pranë Ministrisë së Shëndetësisë).
38. Të krijojë Laborator Referimi në Kontrollin Mjedisor (ndoshta pranë Ministrisë së Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujrave).
39. Të krijojë një Laborator Mjekoligjor (ndoshta pranë Ministrisë së Drejtësisë).
40. Të implementojë një sistem për labororet e specializuara në mënyrë që nga pikëpamja

administrative të jenë pjesë e organizatës së tyre mëmë por që të jenë tërësisht të gjurmueshme për ANMI, dhe aktivitetet e tyre të bashkërendohen nga DPMK nga pikëpamja e kapacitetit të matjeve.

vi. Verifikimi

41. Të zhvillojë më tej disa prej matjeve ANMI, në mënyrë që ato gjithashtu të plotësojnë kërkesat ligjore të metrologjisë.

42. Të përmirësojë tre Qendra Rajonale në Fier, Lezhe, Korçë në lidhje me pajisjet, ambientet dhe burimet njerëzore.

43. Të vendosë autolaboratore për matje me bazë në tre qendra rajonale dhe në selinë e DPMK, në mënyrë që të minimizohet infrastruktura e matjeve e kërkuar në zyrat në rrethe.

44. Të përdorë stafin e zyrave në rrethe për të marrë pjesë në aktivitete të Mbikqyrjes Metrologjike.

vii. Miratimi tip

45. Të përgatisë dhe implementojë legjislacionin dytësor për pranimin e raporteve të testimit të prodhimeve, të përgatitura nga laboratorët e huaja dhe lokale të akredituara, për qëllim të nxjerrjes së miratimeve tip për produktet e reja.

46. Të bashkërendojë operacionet në të gjitha skemat e çertifikimit të shërbimit dhe testimit të të gjitha produkteve të përdorura në rregullatorë të ndryshëm në Shqipëri, në mënyrë që të ketë një sistem uniform me ndikim të lartë rregullator.

viii. Mbikqyrja metrologjike

47. Të punësojë 5 persona të tjerë që numri i tyre të arrijë në 17 deri në fund të afatit.

48. Të trajnojë stafin egzistues dhe të ri në qendrat rajonale dhe zyrat në rrethe, në mënyrë që ata të mund të funksionojnë si pjesë e sistemit të mbikqyrjes metrologjike.

49. Të hartojë dhe implementojë operacione në fushat relevante të ndryshme nga sasia në mallrat e paraambalazhuara.

50. Të hartojë dhe implementojë një program plotësues për mbikqyrjen metrologjike në nivel prodhimi si dhe në nivel tregu.

c. Vlerësimi i konformitetit dhe akreditimi

51. Të konsolidojë kompetencën e DPA për fushat e veprimit të akreditimit aktual;

52. Të zgjerojë fushën e veprimit të akreditimit të DPA;

53. Të rrisë kapacitetin e DPA për të marrë përsipër detyrën e ruajtjes dhe rritjes së kompetencës të vlerësuesve të saj dhe atë të organeve të vlerësimit të pajtueshmërisë;

54. DPA bëhet anëtare e EA/MLA për organet e çertifikimit QMS, organet e çertifikimit të personelit, laboratorët e testimit dhe kalibrimit;

55. Të rrisë ndërgjegjësimin e industrisë, autoriteteve publike, konsumatorëve etj, mbi çështjet e cilësisë, akreditimit dhe standardizimit;

56. Akreditim në fushën e rregulluar;

57. Të forcojë bashkëpunimin rajonal dhe ndërkombëtar.

Objektiva specifike (2013-2017)

Ky kre përmbledh objektivat specifike të zhvillimit për periudhën 5 vjeçare (2013-2017).

a. Metrologjia

i. Standardet Kombëtare të Matjeve

1. Të krijohen dhe ruhen në mënyrën e duhur standardet kombëtare në të 46 fusha të matjeve.

ii. Funksionet e Institutit të Metrologjisë

2. Të krijojë 13 fusha të reja matjesh që e çojnë në 46 numrin total të fushave operacionale të matjeve.

3. Të punësojë, trajnojë anëtarë të rinj të stafit në mënyrë që deri në fund të vitit 2017, DPMK të ketë një personel prej 138 personash, 44 prej të cilëve janë kërkues.

4. Të përditësojë këtë Strategji IC në mënyrë që të vazhdojë mbulimin për 15 vitet e ardhshme.

5. Të ndryshojë fushën e veprimit të akreditimit të laboratorve ANMI për të mbuluar të paktën 40 prej 46 fshave të matjeve ku ANMI do të jetë aktive.

6. Të vendosë gjurmueshmëri në mënyrën e duhur në të 46 fushat e matjeve.

7. Të ketë të paktën 35 prej 46 fshave të matjeve, të njohura nga EUROMET dhe BIPM.

8. Të menaxhojë Sistemin e Cilësisë në mënyrë që të mbulojë edhe fushat e reja të matjeve.

9. Të sigurojë që të gjitha laboratorët të jenë paktën në nivelin “dytësor të lartë”.

10. Të ketë të paktën pesë laboratore në nivelin “dytësor të ulët”.

11. Të marrë pjesë në krahasime për të paktën 25 prej 33 fshave të matjeve.

12. Të trajnojë në nivelin e duhur të 34 kërkuesit që punojnë pranë ANMI.

13. Të hapë një reparat riparimi e mirembajtje të pajisjeve dhe instrumenteve elektronike ndërtesën e re.

14. Të përmirësojë bibliotekën në ndërtesën e re me të paktën 140 libra në metrologji dhe abonim në të paktën 25 gazeta shkencore.

15. Të krijojë një Sistem modern teknologjie informacioni pranë DPMK dhe të ketë të paktën 75% të

shpërndarjes së informacionit të brendshëm në formë elektronike.

16. Të sigurojë trajnime të rregullta për industrinë në të paktën 16 fusha, duke përfshirë metrologjinë e përgjithshme dhe vlerësimin e pasaktësisë.

17. Të fillojë përgatitjen e specifikimeve teknike të ndërtesave të ardhshme.

18. Të rrisë ndërveprimet me WELMEC.

19. Të zhvillojë aktivitetet e ALBLAB, në mënyrë që të paktën një konferencë e rëndësishme të organizohet çdo vit (mund të zhvillohet në Ditën Botërore të Metrologjisë).

20. Të marrë pjesë në të gjitha komitetet teknike të EUROMET-it dhe në disa komitete teknike të IMEKO-s.

21. Të organizojë të paktën tre takime të komitetit teknik në Tiranë në këtë afat.

22. Të publikojë të paktën pesë dokumenta shkencore dhe të zhvillojë dhjetë diskutime shkencore në të paktën katër takime ndërkombëtare.

iii. Kalibrimi

23. Të arrijë të paktën 120 kalibrime në vit deri në fund të afatit, në 46 fusha matjesh.

24. Të ndihmojë industrinë dhe DPA që të kenë të paktën tre laboratore të akredituara kalibrimi (jashtë sistemit DPMK).

iv. Infrastruktura e testimit

25. Të rrisë sasinë e testimeve në ANMI (siguria elektrike, mjedisore, mekanike, kimike, materiale).

26. Të ndihmojë industrinë dhe DPA të kenë të paktën 18 Laboratore të Akredituara Testimi në

Ushqim/mikrobiologji

Mjedis

Shëndetësi

Tekstile

Testime elektrike

Ndërtim

Produktet kimike/të naftës

Lëndë plasëse

v. Laboratorët e specializuara

27. Të përmirësojë operacionet e laboratoreve egzistuese shëndetësore, kontrollit mjedisor dhe ato mjekoligjore, në mënyrë që të operojnë si laboratore referimi në fushat e tyre dhe të akreditohen.

28. Të hapë Laboratorin e Referimit në Ndërtim (vendndodhja do të përcaktohet më pas).

29. Të hapë Laboratorin e Kontrollit të Dopingut (ndoshta pranë Ministrisë së Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve).

30. Të hapë Laboratorin e Testimit të Materialeve (vendndodhja duhet të përcaktohet më pas).

31. Të hapë Laboratorin e Telekomunikacioneve (ndoshta pranë Ministrisë së Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit).

vi. Verifikimi

32. Të përmirësojë më tej tre Qendrat Rajonale në Fier, Lezhë, Korçë në lidhje me pajisjet, ambientet dhe burimet njerëzore.

33. Të zgjerojë operacionet e autolaboratoreve të matjeve.

34. Të trajnojë stafin e Qendrave Rajonale dhe Zyrave në rrethe për të marrë pjesë si në aktivitetet e Metrologjisë Ligjore dhe në ato të Mbikqyrjes Metrologjike. Të sigurojë që edhe një shofer autolaboratori të jetë i aftë të merret me mbikqyrjen ose verifikimin e peshave, volumeve, pompave të naftës etj.

vii. Miratimi tip

35. Të zgjerojë fushën e veprimit të operacioneve.

viii. Mbikqyrja metrologjike

36. Të punësojë 3 persona të tjerë në mënyrë që numri të arrijë në 20 deri në fund të afatit.

37. Të trajnojë më tej stafin egzistues dhe të ri në qendrat rajonale dhe zyrat në rrethe, në mënyrë që të funksionojë si pjesë e sistemit të mbikqyrjes metrologjike.

38. Të zgjerojë fushën e veprimit të operacioneve sipas ligjit të ri mbi metrologjinë.

b. Vlerësimi i konformitetit dhe Akreditimi

39. Të zgjerojë fushën e veprimit të akreditimit të DPA ndaj organizatoreve të testeve të zotesise (PT) dhe prodhuesve të CRM (vazhdim i obj. 52 në fazën e mëparshme);

40. DPA bëhet anëtare e EA/MLA për akreditimin e organeve të çertifikimit të sistemeve të menaxhimit të mjedisit, organeve të çertifikimit të produkteve dhe organeve të inspektimit (vazhdim i objektivit 54 në fazën e mëparshme);

41. Të rrisë ndërgjegjësimin e industrisë, autoriteteve publike, konsumatorëve etj, mbi çështje të cilësisë, akreditimit dhe standardizimit (vazhdim i objektivit 55 në fazën e mëparshme);

42. Akreditimi në fushën e rregulluar (vazhdim i objektivit 56 në fazën e mëparshme);

43. Të forcojë bashkëpunimin rajonal dhe ndërkombëtar (vazhdim i objektivit 57 në fazën e

mëparshme).

Objektiva specifike (2018-2022)

Ky kre përmbledh objektivat specifike të zhvillimit për periudhën 5 vjeçare (2018-2022).

Metrologjia

1. Standardet Kombëtare të Matjeve

1. Të krijohen dhe ruhen në mënyrën e duhur standardet kombëtare në të 60 fushat e matjeve.

2. Funksionet e Institutit të Metrologjisë

2. Të kompletojnë një ndërtesë të re me të paktën 4000 m² të laboratoreve të specializuara, të përshtatshme gjithashtu për testimin e materialeve dhe produkteve dhe të ketë kontroll të përshtatshëm mjedisor.

3. Të sigurojnë që të gjitha laboratorët në të dyja ndërtesat të jenë tërësisht operacionale.

4. Të koordinohet me Institutin e Fizikës Bërthamore që të ketë matje rrezatimi jonizues në ANMI.

5. Të krijojnë 14 fusha të reja matjesh që e çojnë numrin total të fushave operacionale të matjeve në 60.

6. Të punësojnë, trajnojnë anëtarë të rinj të stafit në mënyrë që deri në fund të vitit 2017, DPMK të ketë një personel prej 142 personash, 51 prej të cilëve janë kërkues

7. Të përditësojnë këtë Strategji IC në mënyrë që të vazhdojnë mbulimin për 15 vitet e ardhshme të zhvillimit.

8. Të ndryshojë fushën e veprimit të akreditimit të laboratoreve ANMI për të mbuluar të 60 fusha të matjeve ku ANMI do të jetë aktive.

9. Të vendosë gjurmueshmëri në mënyrën e duhur në të gjitha 60 fushat e matjeve.

10. Të ketë të 60 fushat e matjeve të njohura nga EUROMET dhe BIPM.

11. Të menaxhojë Sistemin e Cilësisë në mënyrë që të mbulojë edhe fushat e reja të matjeve.

12. Të ketë të gjitha laboratorët të paktën në nivelin "Dytësore e Lartë".

13. Të ketë të paktën gjashtë laboratore në nivelin "Parësore e Ulët".

14. Të ketë të paktën një laborator në nivelin "Parësore mesatare".

15. Të marrë pjesë në krahasime për të 60 fushat e matjeve.

16. Të trajnojnë në nivelin e duhur të 51 kërkuesit që punojnë pranë ANMI-t.

17. Të krijojnë një repart mekanik për riparime e mirëmbajtje të domosdoshme të pajisjeve të laboratoreve në ndërtesën e re.

18. Të fillojë sigurimin e shërbimeve elektronike dhe mekanike në universitete dhe në industri në lidhje me riparimin, projektimin dhe ndërtimin e pajisjeve të matjeve.

19. Të përmirësojë më tej bibliotekën në ndërtesën e re me të paktën 160 libra mbi metrologjinë dhe abonim në të paktën 28 gazeta shkencore.

20. Të krijojnë një Sistem modern teknologjie informacioni pranë DPMK dhe të ketë të paktën 90% të shpërndarjes së informacionit të brendshëm në formë elektronike.

21. Të sigurojnë trajnime të rregullta për industrinë në të pakën 30 fusha, duke përfshirë metrologjinë e përgjithshme dhe vlerësimin e pasaktësive.

22. Të bëhet anëtar i WELMEC.

23. Të mbështesë ALBLAB, në mënyrë që përveç një konference të përgjithshme çdo vit, të organizohen të paktën 5 workshope të specializuara në fusha të ndryshme matjesh.

9. Të përgatisë një plan për krijimin e një reparti makinerish në ndërtesën e re, në mënyrë që disa riparime dhe prodhime pajisjesh të mund të bëhen në ambientet e brendshme

10. Të përditësojë Sistemin e Cilësisë në DPMK

11. Të përcaktojë nevojat për infrastrukturën e teknologjisë së informacionit për 5 vitet e ardhshme dhe e përditëson atë në mes të çdo viti

12. Të implementojë Planin e Zhvillimit të Bibliotekës

13. Të fillojë procesin për prokurimin e mallrave sipas Planit 5 vjeçar të Investimit

14. Të hartojë një program trajnimi dhe shpërndarjeje informacioni për industrinë dhe ta implementojë atë

15. Të aplikojë për anëtarësim në WELMEC

16. Të punojë me ALBLAB, për të organizuar një konferencë të madhe ndërkombëtare, preferohet në ditën botërore të metrologjisë dhe 5 workshope të specializuara në fusha të ndryshme matjesh

17. Të sigurojë që stafi teknik i ANMI të marrë pjesë në të gjitha takimet e Komitetit Teknik EUROMET dhe në sa më shumë takime që të jetë e mundur në IMEKO

18. Të organizojë të paktën tre takime të Komitetit Teknik EUROMET në ndërtesën e re
19. Të publikojë të paktën 10 dokumenta në Matje ose në gazeta të ngjashme për 5 vitet e ardhshme. Të bëjë të njëjtën gjë për të zhvilluar 20 prezantime shkencore në konferenca ndërkombëtare. Të organizojë dy workshope ndërkombëtare (në nivel EUROMET),
20. Të përgatisë të gjithë kërkuesit që punojnë në laboratore si vlerësues teknikë për akreditimin e laboratoreve të kalibrimit
21. Të nxisë organizatat relevante që të operojnë laboratore kalibrimi dhe t'i ndihmojë ato të akreditohen
22. Të rrisë kapacitetin testues të ANMI, veçanërisht në fushat e testimit elektrik, mjedisor, kimik, mekanik dhe material
23. Të nxisë organizatat relevante që të bëjnë testime në ushqime/mikrobiologji, mjedis, teste elektrike, testimin e materialeve të ndërtimit, kimikateve dhe produkteve të naftës. T'i ndihmojë ato të akreditohen
- ii. METE
24. Siguron mbështetje për implementimin e kësaj Strategjie dhe të Projekteve BERIS.
25. Vendos kontakte me ministrinë e tjera dhe rregullatorët për bashkërendimin e infrastrukturës së matjeve.
- iii. Të tjera
26. Të gjithë laboratorët e specializuar të referimit që janë krijuar më parë (Ushqimor, Veterinar, Shëndetësor, të Kontrollit Mjedisor, Mjekoligjor, të Kontrollit të Dopingut, Ndërtimit, Testimit të Materialeve, Telekomunikacionit) duhet të akreditohen.

RRJEDHOJAT PER BURIMET

a. Kostot

Analiza e detajuar e kostos është pothuajse e pamundur në këtë fazë. Kur secila organizatë përgatit planin e saj të biznesit, në këtë fazë mund të përgatiten inventarët e kostos reale. Nga ana tjetër, duke përdorur zhvillimet e ngjashme në katër vendet e tjera që janë përdorur si model për zhvillim dhe duke përdorur Modelin e Zhvillimit, është e mundur të propozohet një plan investimi i cili jep një vlerësim pozitiv të kostove, veçanërisht për pjesën e metrologjisë ku nevojiten të bëhen shumica e investimeve.

Tabela e mëposhtme përmbledh kostot e investimit. Është e arsyeshme të pretendohen kosto rrjedhëse si mesatarisht 25 % të kostove të investimit. Megjithatë, ky raport duhet të përcaktohet për Shqipërinë nga organizatat përkatëse për vlerësim më të saktë të kostove totale. Derisa të bëhet kjo, llogaritet një vlerësim i përafërt i kostove rrjedhëse deri në vitin 2030 derisa investimet e metrologjisë të kenë një jetëgjatësi ekonomike. Pas vitit 2030, mund të nevojitet një "ripërpunim" thelbësor me qëllim që të zëvendësojë pajisjet e vjetëruara dhe jofunksionale, si dhe rregullimin e hapësirës laboratorike.

Për standardizimin dhe akreditimin, pjesa më e madhe e kostove rrjedhëse është për shkak të rrogave dhe shpenzimeve për shërbimet komunale. Nëse nevojitet, këto mund të vlerësohen lehtësisht dhe të përfshihen në tabelë.

Kostot e investimit paraqiten në tabelën e mëposhtme.

Kostot grupohen në katër faza:

Faza I:	2008-2012	Faza fillestare
Faza II:	2013-2017	Faza e zhvillimit
Faza III:	2018-2022	Faza e pjekurisë
Faza IV:	2023-2030	Faza e përfitimit

Faza fillestare është ajo në të cilën do të bëhen shumica e investimeve. Investimet për Standardizimin do të përfundojnë në këtë fazë. Shumica e zhvillimeve të Akreditimit do të ndodhin në këtë fazë. Në fazën e zhvillimit do të përfundojnë gjithashtu investimet në Akreditim. Në fazën e pjekurisë të treja organizatat IC do të zhvillohen më tej dhe kryesisht do të vazhdojnë investimet për metrologjinë. Në fazën e përfitimit, metrologjia do të gjenerojë të ardhura të konsiderueshme dhe të ardhurat e saj do të jenë më shumë sesa shpenzimet që bën në këtë fazë.

i. Kostot e investimit për zhvillimin e Metrologjisë në Shqipëri (në milion leke)

Kostot e investimit për metrologjinë grupohen në ndërtim të godinave të reja, mallra (si pajisjet, edhe softueri) dhe transferimi i ekspertizës.

(trajnim dhe konsulentë). Kostot operacionale grupohen si rroga, shpenzime për shërbime komunale, kosto në lidhje me metrologjinë si kalibrimet, krahasimet, riparimi dhe kosto të tjera.

Kostot e Investimit për pjesën e metrologjisë

A	Numri i	Pajisje	Kostot	Transferim	Investimi
Viti	Personelit	Programe	Punë Civile	Njohuri Teknike	Total

2008	103	88.125	25.000	78.000	191.125
2009	105	123.750	250.000	24.000	397.750
2010	120	38.750	187.500	27.000	253.250
2011	124	295.000		23.625	318.625
2012	128	105.000		15.500	120.500
2013	133	110.000		11.250	121.250
2014	136	260.000		11.750	271.750
2015	137	73.750		9.125	82.875
2016	137	128.750		8.250	137.000
2017	138	91.250		8.375	99.625
2018	138	45.000		140.000	185.000
2019	139	196.250	500.000	44.375	740.625
2020	140	62.500	375.000	31.875	469.375
2021	141	56.250		5.875	62.125
2022	142	1.250		4.250	5.500
2023	142			3.750	3.750
2024	143			3.250	3.250
2025	143			2.750	2.750
2026	144			2.250	2.250
2027	144			1.750	1.750
2028	145			1.250	1.250
2029	145			1.250	1.250
2030	145			1.250	1.250
Totali		1.675.625	1.337.500	460.750	3.473.875

Kostot e Investimit për pjesën e metrologjisë

A	Numri i Personelit	Pagesat	Shërbime Komunale	Riparime Krahاسimi Gradimi	Të Tjera	Kostoja Totale Rrjedhëse
Viti						
2008	103	45.750	3.125	875	10.000	59.750
2009	105	47.553	3.750	1.000	10.625	62.928
2010	120	55.298	5.000	1.125	13.125	74.548
2011	124	58.247	6.875	1.250	14.500	80.872
2012	128	61.291	8.125	1.375	15.750	86.521
2013	133	64.911	8.750	1.500	17.125	92.286
2014	136	67.673	9.125	1.750	18.250	96.798
2015	137	69.524	9.500	2.000	19.125	100.149
2016	137	70.915	10.000	2.500	20.000	103.415
2017	138	72.851	10.500	3.000	21.000	107.351
2018	138	74.308	11.000	3.500	21.875	110.683
2019	139	76.332	11.500	4.000	23.000	114.832
2020	140	78.408	12.500	4.625	24.375	119.908
2021	141	80.536	13.750	5.375	25.750	125.411
2022	142	82.718	15.000	6.000	27.250	130.968
2023	142	84.373	15.750	6.750	27.500	134.373

2024	143	86.654	16.250	7375	27.500	137.779
2025	143	88.387	16.500	8.125	27.500	140.512
2026	144	90.773	16.750	8.625	27.500	143.648
2027	144	92.589	17.125	9.125	27.500	146.339
2028	145	95.083	17.500	9.625	27.500	149.708
2029	145	96.990	17.875	9.375	27.500	151.740
2030	145	98.930	18.250	9.375	27.500	154.055
Totali		1.740.094	274.500	108.250	501.750	2.624.594

Kostot e Investimit për zhvillimin e Standardizimit në Shqipëri (ne leke)

Kostot e Investimit për Standardizimin jepen për sa i përket 3 objektivave kryesore. Një gjë e tillë e bën praktike zgjedhjen e objektivit të nevojshëm, dhënien e prioritetit dhe përgatitjen e projektit për qëllimin e zgjedhur.

Nuk egzistojnë punime civile të nevojshme dhe pajisjet/produktet përmbajnë si pajisje mekanike/hardware ashtu edhe programe/software dhe njohuritë teknike përmbajnë si trajnime ashtu edhe konsulencë.

/000 leke

	2008		2009		2010		2011		2012		
	Pajisje/ produkt e	Transferim i njohurive teknike	Pajisje/ produkte	Transferim i njohurive teknike	Pajisje/ produkte	Transferim i njohurive teknike	Pajisje/ produkte	Transferim i njohurive teknike	Pajisje/ produkte	Transferim i njohurive teknike	
Permbushja e 9 kushteve		6250		6250		6250		3750		3750	26 250
Adoptimi i EN	2500	5000		3750		1250					12 500
Aktivitetet promocional e	5000	625	3750	625	3750	625	3125		1875		19 375
											58 125

ii. Kostot e Investimit për zhvillimin e Akreditimit në Shqipëri (ne leke)

Kostot e Investimit për Akreditimin jepen për sa i përket objektivave. Një gjë e tillë e bën praktike zgjedhjen e objektivit të nevojshëm, dhënien e prioritetit dhe përgatitjen e projektit për qëllimin e zgjedhur.

Nuk egzistojnë punime civile të nevojshme dhe mallrat përmbajnë si pajisje mekanike/hardware ashtu edhe programe/software

Njohuritë teknike (shkurt know how) përmbajnë si trajnime ashtu edhe konsulencë.

/000 leke

Viti	Objektivi I	Objektivi II	Objektivi III	Objektivi IV	Objektivi V	Objektivi VI	Objektivi VII	Totali
------	-------------	--------------	---------------	--------------	-------------	--------------	---------------	--------

	Know how	Te nevojshme	Know how	Te nevojshme	Know how	Te nevojshme	Know how	Te nevojshme	Know how	Te nevojshme	Know how	Te nevojshme	Know how	Te nevojshme	
2008	1292 5		3200		4150	875	3287. 5	2875	1250	625	550				29737. 5
2009	2300		2500		912.5		2787, 5		1250	625					10375
2010	2300		2500		1825				1250	625			625		9125
2011	2300		2500		1825		2787, 5		1250	625					11287. 5
2012	2300		2500						3750	625					9175
2013									3750	625	5000		2500		11875
2014									1250	625	5000				6875
2015									1250	625	5000				6875
2016									1250	625	5000				6875
2017									1250	625	5000				6875
Tota l	2212 5		1320 0		8712. 5	875	8862. 5	2875	1750 0	6250	2555 0		3125		109025

Tabela e Konsoliduar për të tre institucionet e Infrastruktures se Cilesise:

	Punime	Te nevojshme	Transferim i njourive	Totali
2008	28125	106875	115237	250237
2009	268750	161875	44375	475000
2010	206250	63125	43625	313000
2011		298750	38037	336788
2012		143750	27800	171550
2013		110625	22500	133125
2014		260625	18000	278625
2015		74375	15375	89750
2016		129375	14500	143875
2017		91875	14625	106500
2018		45000	140000	185000
2019	500 000	196250	44375	740625
2020	375000	62500	31875	469375
2021		56250	5875	62125
2022		1250	4250	5500
2023			3750	3750
2024			3250	3250
2025			2750	2750
2026			2250	2250
2027			1750	1750
2028			1250	1250
2029			1250	1250
2030			1250	1250
Total	1378125	1801875	612950	3792950

Kostot e Investimit Total per te tre institucionet e Infrastruktures se Cilesise për çdo fazë:

Faza I (2008-2012)	Kostot e Investimeve (në milion leke)
Standardizim	58.125
Metrologjia	1418.750
Akreditimi	69.750
Totali	1546. 625
Faza II (2013-2017)	Kostot e Investimeve
Metrologjia	712.500
Akreditimi	39.375
Totali	751.875
Faza III (2018-2022)	Kostot e Investimeve
Metrologjia	1462.625
Totali	1462.625
Faza IV (2023-2030)	Kostot e Investimeve
Metrologjia	0,140
Totali	17.500
Totali	Kostot e Investimeve
Standardizimi	58.125
Metrologjia	3611.375
Akreditimi	109.125
Totali	3778.625

PERFITIMET E PRITSHME NGA SISTEMI I INFRASTRUKTURES SE CILESISE

Impakti Potencial i sistemit të IC-se

Nëse implementohet me sukses, sistemi i IC do të ketë një impakt të rëndësishëm mbi zhvillimin ekonomik dhe industrial të Shqipërisë. Përfitimet dhe kontributet mund të përmbledhen në pesë kategori kryesore:

Industria

Standardizimi, çertifikimi dhe mbrojtja e pasurisë intelektuale janë çështjet më themelore për një prodhim industrial të qëndrueshëm. Këto janë parametra të nevojshëm por jo të mjaftueshëm. Me qëllim zotërimin e një pjesë më të madhe të tregut, cilësia gjithashtu mbetet themelore dhe faktori më i rëndësishëm për të mbetet testimi dhe vlerësimi. Të gjitha testet dhe vlerësimet/matjet realizohen në laboratore të akredituara.

Organizatat e IC do të sigurojnë infrastrukturën e nevojshme të nevojshme për zhvillimin industrial të Shqipërisë. Në shoqëritë moderne aktivitetet që kanë të bëjnë me vlerësimin/matjen zënë 1-12% të Prodhimit të Brendshëm Bruto. Pritet që një gjë e tillë të ndodhë në Shqipëri mbas 5 deri në 10 vjetë.

i. Tregtia

Në shekullin e 21 asnjë vend nuk mund të ecë pa një tregti të gjerë me vendet e tjera. Kjo qëndron edhe për Shqipërinë. Mallra me vlerën e miliona Eurove tregtohen nga ana e kompanive Shqiptare qofshin ato private apo shtetërore. Për artikuj të importuar cilësia dhe konformiteti me standartet Shqiptare mbetet e rëndësishme. Në këtë rast përballemi me dy probleme: egzistencën e standarteve të duhura dhe implementimin e standarteve nëpërmjet testeve, vlerësimeve/matjeve dhe inspektimit. Këtu organizatat e IC do të luajnë një rol tepër kritik si për përgatitjen e standarteve ashtu dhe për implementimin e tyre nëpërmjet testeve, vlerësimeve/matjeve, inspektimeve, çertifikimit dhe akreditimit.

Në të njëjtën mënyrë, për mallrat e eksportuara nevojitet një farë bindje për konsumatorin potencial në mënyrë që prodhimet Shqiptare të jenë më të mira se konkurenca. Si për mallrat e importuara, kjo kërkon një kontroll cilësie të rreptë nëpërmjet testeve, vlerësimeve, inspektimit, çertifikimit dhe akreditimit. Organizata e IC do të jenë në gjendje të plotësojnë kërkesat e industrisë Shqiptare për të siguruar infrastrukturë të besueshme tregtare.

ii. Shkenca dhe Teknologjia

Kur një sistem modern vlerësimi/matje nevojitet dhe krijohet, kjo shkakton sinergji në zhvillimin shkencor dhe teknikë të vendit në fjalë. Kjo për shkak të faktit se shumë teste dhe vlerësime/matje kërkojnë teknika tejet të avancuara të cilat mund të mbështeten në një mjedis të shëndoshë shkencor dhe teknologjikë. Një gjë e tillë promovon më mirë produktet industriale dhe një tregti më të besueshme. Instituti i Metrologjisë do të jetë në gjendje të realizoj kontribute të njëjta nëse shvillohet si duhet dhe gëzon mbështetjen e qeverisë.

Në shumë programe të IC kthimi i investimit qëndron ndërmjet 5 and 42. Edhe nëse marrin shifrën më të ulët, Shqipëria do të përfitojë afërsisht 5 herë më shumë sesa fondet e realizuara nëpërmjet realizimit të kësaj Strategjie për kohëzgjatje ekonomike të investimeve. Kohëzgjatja ekonomike e investimeve është afërsisht 15 vjetë.

iii. Njohja Ndërkombëtare

Çdo organizim gjithmonë ka rregulla për antarësim. Një gjë e tillë vlen gjithashtu për njohjen e Sistemit IC të Shqipërisë nga komuniteti ndërkombëtar, veçanërisht nga Bashkimi Evropian, Amerika e Veriut, Japonia dhe shtete të tjera. Për ti komplikuar gjërat, egzistojnë organizata me rregulla të ndryshme. Shtetet janë anëtarë të Organizatës Botërore të Tregtisë (OBT) dhe/ose të Bashkimit Evropian. Por organizatat e IC duhet të jenë anëtare si të organizatave rajonale ashtu edhe të organizatave ndërkombëtare. Për shembull, organizatat e standartizimit duhet të bëhen anëtare të ISO, IEC (nivel ndërkombëtar), CEN, CENELEC dhe ETSI (Evropian). Në të njëjtën mënyrë për organizatat e akreditimit organizmat korrespondues janë ILAC, IAF (Ndërkombëtar), EA (Evropian). Si zakonisht situata në metrologji komplikohet më tej pasi egzistojnë tre tipe të metrologjive (shkencore, industriale dhe ligjore). Organizatat e metrologjisë janë BIPM, OIML dhe IMEKO (ndërkombëtare) dhe EUROMET, WELMEC, EUROLAB (Evropiane). Aktualisht si Organizata Botërore e Tregtisë (OBT) ashtu edhe BE kërkojnë antarësim dhe “pozitë të mirë” në këto organizata për lëvizjen e lirë të mallrave dhe tregtinë e lirë. Prandaj, antarësimi në këto organizata ndërkombëtare dhe njohja ndërkombëtare mbetet themelore për tregtinë me jashtë të Shqipërisë dhe për antarësimin e saj në BE.

iv. Përfitimet Ekonomike

Për investimet që do të realizohen ndërmjet viteve 2007 dhe 2023, planifikohet një harxhim total afërsisht prej 4375 milion leke, përfshirë trajnimin, godinat e reja dhe të gjitha kostot rrjedhëse. Ky harxhim përfshin gjithashtu investime jashtë DPMK Për kohëzgjatjen ekonomike të këtyre investimeve (deri në vitin 2030), të ardhurat direkte afërsisht parashikohen në 6625 milion leke dhe përfitimet indirekte planifikohen afërsisht në 45500 milion leke. Për shkak të investimeve në Infrastrukturën e Vlerësimit/Matjes në Shqipëri, Prodhimi i Brendshëm Bruto mund të rritet me rreth 0,11% çdo vit.

Vlerësimi i Kthimit të Investimit për Investimet Metrologjike

Grupi Investimit	(në milionë leke)				
	Faktorët ROI (1)		Kostoja	ROI	
	Direkte	Indirekte		Direkte	Indirekte
M (Masa, Presioni, Vakumi, Forca, Torque, Fortësi, Dëndësia)	362.500	5000	268.75	779375	10750.00
V (Rrjedhë, Volumi)	262.500	2000	52.50	97.532	840.00
L (Gjatësia, Këndi, Forma, Përmasat 3-D, Përmasat Dimensionale të Tjera)	300.000	2500	177.50	426.00	3550.00
A (Akustika, Vibracioni, Ultrasonik)	150.000	1000	50.00	53.310	400.00
T (Temperatura, Lagështia)	275.000	2125	92.50	203.50	1572.50
P (Fotometri and Radiometri)	112.500	875	58.75	52.875	411.25
F (Koha dhe Frekuenca)	100.000	750	52.50	42.00	315.00
E (Matjet Elektrike)	287.500	2250	76.25	175.375	1372.5
C (Matjet Kimike)	137.500	1500	123.75	136.125	1485.00
Q (Metrologjia Ligjore)	10000.000	47500	50.00	40000.00	19000.00
X (Pajisje për Matjet e Jashtme)	125.000	1250	561.25	561.25	5612.50
S (Mbështetje Teknike)	625000	125	53.75	26.675	53.75
I (Teknologjitë IT)	0	0	58125	0,000	0,000
B (Konstruktionet)	0	0	1337.50	0,000	0,000
Y (Projektimi dhe Kontrolli i Punimeve Civile)	0	0	253.125	0,000	0,000
K (Transferimi i Njohurive Teknike)	12.500	125	190.125	19.00	190.125
Kohëzgjatja e Investimit (2008-2030)					
Kohëzgjatja e Përfitimit (2008-2030)					
Kostot e Investimit			3375.00		
Kostot Rrjedhëse			2750.00		
Kostoa Totale			6125.00		
Përfitimet Totale				6875.00	45552.625
Raporti Përfitim/Kosto				1.526	10.543
Kosto/viti			266.25		
Përfitimi Direkt/Viti			298.875		
Efekti mbi PBB (GDP)/Viti			1980.50		
PBB (GDP) (2006)			1871.25		
Raporti (%)			0,11		
Kontrolli i Përputhshmërisë (Turqi)			0,09		

Vlerësimet fillestare tregojnë për një kosto afërsisht 3375 milion leke për investimet dhe 2750 mili leke për kostot rrjedhëse. Kthimi direkt i investimit parashikohet 6875milion lekemesatarisht dhe këto investime planifikohen të shkaktojnë rritjen e GDP me 0,11% çdo vit. Për të kontrolluar nëse kjo shifra ka kuptim, shifra korresponduese për Turqinë është 0,09%. Kjo është shumë e afërt dhe brënda pasigurisë së arsyeshme.

PERFITIMET E PRITSHME NGA SHERBIMET E METROLOGJISE

Të ardhurat e pritshme për DPMK për shërbimet e saj për industrinë grupohen në 5 grupe. Shërbimet bazë janë gradimi, testimi dhe verifikimi. Nga ana tjetër, do të egzistojnë të ardhura të rëndësishme të krijuara nga sigurimi i trajnimit dhe konsulencës, nga pjesëmarrja në projekte dhe tendera ndërkombëtar, nga shitja e botimeve, informacionit të bazuar në internet, nëpërmjet organizimit të mbledhjeve dhe sigurimit të shërbimeve riparuese dhe mirëmbajtëse.

Ne milion leke

A Viti	Kalibrimi Testimi Verifikimi	Trajnimi	Konsulenca Projekte Ndërkombëtare	Botime Të ardhura neto, aktivitete	Riparime Mirëmbajtje	Të ardhura Totale
2008	80.00	0.0625		0.006		80.07
2009	85.00	0.125		0.019		85.144
2010	90.00	0.250		0.062		90.312
2011	97.50	0.375	0.0625	0.187		98.125
2012	106.25	0.5625	0.0875	0.312	0.001	107.225
2013	116.25	0.937	0.125	0.625	0.06	118.000
2014	128.75	1.875	0.25	0.937	0.25	132.062
2015	141.25	5.00	1.25	1.56	0.50	149.562
2016	156.25	6.25	3.75	2.50	0.875	169.625
2017	175.00	7.50	6.250	3.125	1.125	193.000
2018	200.00	8.75	9.375	3.75	1.625	223.500
2019	231.25	10.00	12.500	4.375	2.25	260.375
2020	268.75	11.25	18.75	5.00	3.125	306.875
2021	306.25	11.875	25.00	5.625	4.375	353.125
2022	343.75	12.50	31.250	6.25	6.25	400.000
2023	375.00	11.875	31.250	5.625	7.50	431.250
2024	387.50	11.25	31.250	5.00	8.75	443.750
2025	412.50	10.625	31.250	5.00	10.00	469.375
2026	425.00	10.00	31.250	5.00	11.25	482.500
2027	425.00	10.00	31.250	5.00	12.50	483.750
2028	425.00	9375	31.250	5.625	12.50	483.750
2029	425.00	9.375	31.250	6.25	12.50	484.375
2030	425.00	9.375	31.250	6.25	12.50	471.875
Totali	5813.75	159.187	336.15	78.087	107.95	6517.625

Bilanci i pagesave për metrologjinë
Milion leke

A	Investimi	Kostoja	Kostoja	Të ardhura	Bilanci i
Viti	Total	Totale	Totale	nga	pagesave
		Rrjedhëse		shërbimet	
2008	191.125	59.750	250.875	80.069	-167.056
2009	397.750	62.928	460.678	85.144	-375.535
2010	253.250	74.548	327.798	90.312	-237.485
2011	318.625	80.872	399.497	98.125	-301.372
2012	120.500	86.541	207.040	107.125	-99.816
2013	121.250	92.286	213.536	118.000	-95.536
2014	271.750	96.861	368.548	132.062	-236.485
2015	82.875	100.149	183.024	149.562	-33.462
2016	137.000	126.22	240.414	170.000	-70.790
2017	99.625	107.351	206.976	193.000	-13.976
2018	185.000	110.683	295.683	222.250	-72.183
2019	740.645	114.832	855.457	260.375	-595.082
2020	469.375	119.908	589.283	306.875	-282.408
2021	62.125	125.411	187.536	353.125	165.588
2022	5.500	130.968	136.468	400.000	263.532
2023	3.750	134.373	138.122	431.250	293.127
2024	3.250	137.779	141.029	443.750	302.720
2025	2.750	140.512	143.262	469.375	326.113
2026	2.250	143.648	145.898	482.500	336.602
2027	1.750	146.339	148.088	483.750	335.661
2028	1.250	149.708	150.958	483.750	332.792
2029	1.250	151.740	152.990	483.750	331.385
2030	1.250	154.055	155.305	471.875	316.570
Totali	3473.875	2624.594	6098.469	6517.625	419.156

I. Monitorimi

Në fazën e implementimit të Strategjisë IC, monitorimi i duhur i progresit mbetet themelor për arritjen e suksesit. Organizatat e IC duhet të sigurojnë objektivat bazë dhe objektivat (mundësisht vjetor) menjëherë mbas përgatitjes së planeve të biznesit sipas Strategjisë së IC

b. Metrologjia

Numri i kalibrimeve çdo vit.

Numri i tipeve të kalibrimeve të realizuara në vitin në fjalë

Numri i klientëve të cilët përdorën shërbimet e kalibrimit

Përqindja e trajtimit nga ana e DPMK/ANMI të shërbimeve të metrologjisë në Shqipëri

Pjesa e tregut e DPMK/ANMI në kalibrime në Shqipëri

Numri i botimeve në vit

Koha mesatare për çdo kalibrim (minimum, mesatare, maksimum)

Numri i testeve të realizuara

Numri i tipeve të produkteve të testuara

Numri i klientëve të cilët përdorën testimin DPMK/ANMI dhe shërbimet e analizës

Përqindja e trajtimit nga ana e DPMK/ANMI e shërbimeve të testimit në Shqipëri

Pjesa e tregut e DPMK/ANMI në testim dhe analizë në Shqipëri

Koha mesatare për çdo test apo analizë (minimum, mesatare, maksimum)

c. Vlerësimi i Pajtueshmërisë dhe Akreditimi

Numri i certifikatave të akreditimit në vit;

Numri i OVP nga secila kategori e akredituar në secilin vit;

Numri i kompanive të certifikuara në secilin vit;

Numri i produkteve të certifikuara të shitura/vjetor.

Konsultimi

Projekt- Strategjia Sektoriale “Për zhvillimin e Infrastruktures së Cilesisë” ka kaluar procedurën e marrjes së mendimeve në Ministrinë e linjës, të cilat janë shprehur parimisht dakord. Përsa i përket disa sugjerimeve të tyre, u përpoqëm ti reflektonim në material.

LLOGARIDHENIA

Fusha	Viti 2012 Pajtueshmëria Ndërkombëtare	Probleme	Viti 2017 Pajtueshmëria ndërkombëtare	Probleme	Viti 2022 Pajtueshmëria ndërkombëtare	Probleme	
Rregullat teknike	E pjesshme	Mesatare	E pjesshme	Të vogla	E plotë	Nuk ka	
Mbikqyrja e tregut	E pjesshme	Mesatare	E pjesshme	Të vogla	E plotë	Nuk ka	
Standardizimi	E plotë	Nuk ka	E plotë	Nuk ka	E plotë	Nuk ka	
Metrologjia							
Standardet Kombëtare	E pjesshme	Mesatare	E plotë	Të vogla	E plotë	Nuk ka	
Kalibrimi	E pjesshme	Mesatare	E plotë	Të vogla	E plotë	Nuk ka	
Verifikimi	E pjesshme	Mesatare	E pjesshme	Mesatare	E plotë	Të vogla	
Testimi	Nuk ka	Madhore	E pjesshme	Mesatare	E plotë	Nuk ka	
Miratimi i tipit	Nuk ka	Madhore	E plotë	Të vogla	E plotë	Nuk ka	
Mbikqyrja metrologjike	E pjesshme	Mesatare	E plotë	Të vogla	E plotë	Nuk ka	
Akreditim	E pjesshme	Mesatare	E plotë	Të vogla	E plotë	Nuk ka	
Certifikimi	E pjesshme	Mesatare	E pjesshme	Të vogla	E plotë	Të vogla	
Markimi (psh. CE)	E pjesshme	Mesatare	E pjesshme	Të vogla	E plotë	Të vogla	
Bashkërendimi dhe Monitorimi	E pjesshme	Mesatare	E pjesshme	Të vogla	E plotë	Të vogla	

SHTOJCAT

Shtojca A

Referencat

Shtojca B

Lista e Dokumentacionit Përkatës Ligjor

Shtojca C

Kuadri i Strategjisë

Shtojca D

Rezultatet e Modelit të Zhvillimit për Metrologjinë

Shtojca E

Sistemi Egzistues i IC në Shqipëri

Shtojca F

Veprime të Menjëhershme Nevojiten

Shtojca G

Të Dhëna Ekonomike të Përdorura për Modelin

Shtojca A

Referencat

1. PAD, Projekti BERIS , Shqipëri, nga IBRD, Shtator 2006

2. Shqipëri, Projekti BERIS , Strategjia e IC , Raporti Fillestar,

3. Strategjia DPM dhe Plani i Biznesit, nga DPMK, Mars 2007.

4. Raporti Fillestar i Programit CARDS 2003, nga IRMM Nëntor 2004.

5. Raporti mbi analizën e rrjetit egzistues të gjurmueshëm dhe praktikave të kalibrimit pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë dhe Kalibrimit, Shqipëri, nga PTB Qershor 2006.

6. Studim mbi nevojat e Industrive Shqiptare në fushën e kontrollit metrologjik të para paketimit dhe nevoja në vijim për specializimin e laboratorëve të testimit të qëndrave rajonale të DPMK për para paketimin siaps shtrirjes së Direktivave 76/211/EEC, 75/211/EEC, 75/1606/EEC dhe 80/232/EEC të BE, nga CEPEI/PTB, Nëntor 2006.

7. Studim mbi nevojat e mbrojtjes së konsumatorit dhe të mbrojtjes industriale në Shqipëri në kontrollin metrologjik të instrumentave matës dhe nevojën për zgjatje të kontrollit metrologjik të instrumentave sipas shtrirjes së Direktivave 2004/22/EC (MID) të BE dhe specializimi i qëndrave rajonale të DPMK, nga CEPEI/PTB, Nëntor 2006.

8. Shqipëri, Projekti BERIS , Strategjia e IC, Raporti Fillestar i Standartizimit, nga Philippe Dengler, Korrik 2007.

9. Shqipëri, Projekti BERIS, Strategjia e IC, Raporti Fillestar i Akreditimit, nga Daniela Clejanu, Korrik 2007.

Shtojca B

Lista e Dokumentacionit Përkatës Ligjor

- Ligji i Republikës së Shqipërisë “Mbi Njësitë Matëse dhe Kontrollin e Instrumentave Matës (Metrologji), nr. 8996, datë 30.01.2003

- Ligji i Republikës së Shqipërisë “Për Disa Ndryshime në Ligjin nr. 8996, datë 30.01.2003 ‘Mbi Njësitë Matëse dhe Kontrollin e Instrumentave Matës (Metrologji),” nr. 9542, datë 22.05.2006

- Vendimi i Këshillit të Ministrave “Mbi Njësitë Ligjore të Matjes” nr. 431, datë 26.06.2003.

- Vendim i Këshillit të Ministrave “Mbi Organizimin dhe Funksionimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë dhe Kalibrimit”, nr. 216, datë 10.04.2004.

- Urdhëri i Kryeministrit “Mbi Aprovimin e Strukturës dhe Skemës së Organizimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë dhe Kalibrimit”, no. 157, datë 05.10.2004

- Urdhëri i Ministrit të Financave “Mbi Tarifat për Lejimin, Regjistrimin dhe Pagesat për Verifikimin dhe Kalibrimin e Mjeteve Matës dhe Regulloret e Zbatimit të tyre”.

- Ligji Nr. 9824/01.11.2007 mbi akreditimin e organizmave të vlerësimit të konformitetit në Republikën e Shqipërisë;

- Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 854/19.12.2003 mbi organizimin dhe funksionimin e Drejtorisë së Akreditimit;

- Urdhëri i Ministrit nr. 661/29.09.2006 mbi aprovimin e strukturës dhe organizimit të Drejtorisë së Akreditimit;

- Vendimi i Këshillit të Ministrave no. 77/12.02.2004 mbi strukturën dhe nivelin e pagave të punonjësve të DPA.

- Ligji Nr. 8464, datë 11.3.1999 “Për standardizimin”.

- Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 242, datë 28.5.1999 “Për miratimin e kodit të përgatitjes, adoptimit, miratimit dhe zbatimit të standardeve”

- Vendimi i Këshillit të Ministrave 371, datë 4.8.1999 “Për kriteret dhe kompetencat në fushën e standardizimit, certifikimit dhe akreditimit”

- Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 382, datë 23.7.2002 “Për shkëmbimin e informacionit për standardet dhe rregullat teknike”

- Urdhëri i Këshillit të Ministrave Nr. 36, datë 6.5.1999 “Për disa masa për antarësimin e Republikës së Shqipërisë në Organizatën Botërore të Tregtisë”.

Shtojca C

Kuadri i Strategjisë

a. Metrologjia

Fushat kyçe për sa i përket metrologjisë në strategjinë e IC do të përfshijnë:

- urdhra;

- kuadrin ligjor;
- strukturat organizuese;
- masat drejtuese;
- zhvillimin e burimeve njerzore, përfshirë nevojat trajnuese;
- politikat e financimit dhe investimit, përfshirë investimin për testim, trajnim dhe bashkërendim ndërkombëtar;

- planin për arritjen e njohjes ndërkombëtare;
- planin për forcimin e bashkërendimit rajonal dhe ndërkombëtar; dhe

Pjesa e Metrologjisë në strategjinë e IC duhet gjithashtu të përfshij:

- vlerësimi i nevojave të metrologjisë të industrive eksportuese më të rëndësishme të vendit lidhur me kontributin mbi GDP; dhe

- një plan implementimi për strategjinë që reflekton sekuencat dhe fazat e aktiviteteve të rekomanduara të reformës së bashku me përcaktime kohore për realizimin e investimeve shtesë; plani i implementimit duhet gjithashtu të tregoj kostot e vlerësuara për çdo veprim dhe burimin potencial të financimit.

- Planin për forcimin e dialogut ndërmjet DPMK dhe sektorit të biznesit në mënyrë që të mundësohen secili nga institucionet e IC për të përmbushur nevojat e.

- Përcaktimin e mekanizmave nëpërmjet të cilave DPMK do të merrte reagime/feedback nga industria; dhe

- rekomandime për projektimin e një sistemi monitorimi dhe vlerësimi për DPMK për të vlerësuar arritjen e mandatit institucional dhe sigurimin e treguesve mbi nevojën e ri-drejtimit/ndryshimit të planeve të zhvillimit të sistemit të IC dhe nevojave të sektorit të biznesit.

Çdo veprim strategjik i rekomanduar do të duhet të marrë parasysh madhësinë e vendit dhe kërkesën e pritshme për metrologji, dhe më shumë në përgjithësi, kërkesën për shërbime të IC nga industria. Strategjia do të bazohet në përvojën ndërkombëtare dhe praktikën e favorshme për vende me madhësi dhe GDP të njëjtë.

Detyrat e përcaktuara në ToR:

- Të rishikoj, siguroj komente dhe mbështes strategjinë kombëtare mbi metrologjinë sipas EU CARDS 2003 e cila reflekton- ndër të tjera- strategjinë e Marrëveshjes së Stabilizim Asocimit (MSA), afrimin e aktit të legjislationit si dhe raporteve përfundimtare të CARDS 2003 dhe rajonale CARDS 2002.

- Të assistoj DPMK në bashkërendimin e ngushtë të përgatitjes të një strategjie unike të IC (dmth. strategjia afat mesme për zhvillimin e integruar të sistemit kombëtar të IC) e cila do të reflektoj siç duhet strategjitë e akreditimit dhe standartizimit të përgëtitura nga ana e institucioneve përkatëse me ndihmën e ekspertëve ndërkombëtar.

Përfundimet/Outputet e pritshme të kësaj detyre janë si më poshtë:

- Rekomandime me shkrim mbi strategjinë kombëtare të metrologjisë përfshirë planin e veprimit për konsolidimin e laboratorëve të metrologjisë (përgatitur me mbështetjen e EU CARDS);

- Pjesa e draftit të metrologjisë të strategjisë së IC (përgatitur sipas parametrave të përmendur mësipër), përfshirë një raport fillestar ku identifikohen çështjet të cilat nevojiten të merren parasysh në Shqipëri, ku propozohet një metodë dhe një plan pune i detajuar për të trajtuar këto çështje;

- Përfundime/outpute me shkrim për konsideratë të DPMK, ekspertëve të akreditimit dhe standartisimit si dhe për grupet e punës dhe homologët lokal;

- Të dhëna/inpute të cilat konturojnë opsionet për trajtuar çështjet e ndryshme si dhe rekomandimet kyçe të bazuara në konsultime me ekspertët, institucionet dhe zyrtarët e nevojshëm ligjor lokal;

- Raporti përfundimtar konturon rekomandimet specifike për zhvillimin dhe asistencën e mëtejshme teknike të bazuar në rekomandimet kyçe dhe sgon të dhëna/inpute të marra nga përvoja ndërkombëtare.

ii. Programi, Afatet dhe Implementimi

Programi dhe Afatet jepen në Raportin Fillestar për Pjesën e Metrologjisë (Ref. 1).

iii. Metodologjia e Përdorur

Raporti konsideron afat shkurtër periudhën deri në 5 vjet dhe afat mesëm periudhën deri në 15 vjet në fushën e metrologjisë. Pra në këtë mënyrë, pjesa e metrologjisë e Strategjisë së zhvilluar është përgatitur për 15 vjet. Por kjo e bën të nevojshme që Strategjia të rishikohet çdo 5 vjet, nëse jo më shpejt.

Hapat e përdorura për përgatitjen e pjesës së Metrologjisë të Strategjisë konturohen më poshtë:

Hapi 1: Mbledhja e të Dhënave

Hapi 2: Analizimi i të Dhënave

Hapi 3: Zhvillimi i Strategjisë

Hapi 1: Mbledhja e të Dhënave

Më poshtë jepet lista e informacionit të nevojshëm për të përgatitur një Strategji të plotë. Natyrisht vetëm fushat që kanë të bëjnë me metrologjinë të trajtuara në këtë material.

Rishikimi i Sistemit Egzistues (Kërkesa)

- Rishikimi i Indikatorëve Ekonomik.

- Sigurimi i të dhënave mbi konsumatorët, konsumatorët potencial.

- Sigurimi i të dhënave mbi organizatat që përfaqësojnë grupe konsumatorësh.
- Sigurimi i të dhënave për planet e ardhshme të investimit të kompanive.
- Intervistimi i planifikuesve, aksionerëve kryesor.
- Sigurimi i Politikës Industriale të Zhvillimit të vendit.
- Rishikimi i marrëdhënieve ndërkombëtare, detyrimeve.
- Rishikimi i kërkesave ndërkombëtare.
- Rishikimi i sistemit rregullator.
- Rishikimi i kërkesës egzistuese për kontroll dhe inspektim.
- Rishikimi i kërkesës egzistuese për matjen e infrastrukturës për kontroll dhe inspektim.

Rishikimi i Sistemit Egzistues (Oferta)

- Rishikimi i sistemit të standartizimit
- Rishikimi i mekanizmave për kalimin në standarte vullnetare dhe regullore teknike.
- Rishikimi i sistemit të akreditimit
- Rishikimi i sistemit të metrologjisë (metrologjia shkencore, standartet kombëtar)
- Rishikimi i sistemit ligjor të metrologjisë (verifikimi, aprovimi i mënyrës)
- Rishikimi i sistemit të testimit të produktit
- Rishikimi i sistemit të certifikimit
- Rishikimi i sistemit të kontrollit dhe inspektimit
- Rishikimi i sistemit të vlerësimit të pajtueshmërisë
- Rishikimi i sistemit të mbrojtjes së konsumatorit

Hapi 2: Analizimi i të Dhënave

Detyrat e mëposhtme do të implementohen për analizimin e të dhënave të mbledhura.

Vlerësimi i Kërkesave (Ligjore, Organizative)

- Rishikimi i legjislacionit aktual (ligjet, dekretet)
- Rishikimi i praktikave aktuale reale
- Krahësimi i legjislacionit dhe praktikave
- Krahësimi i gjëndjes egzistuese të Sistemit të IC sipas kërkesave të Organizatës Botërore të Tregtisë dhe BE.

- Identifikimi i papajtueshmërinë.

- Përgatitja e të dhënave/inputsve të cilat do të përdoren për Modelin e Zhvillimit.
- Përcaktimi i sektorëve përkatës ekonomik kryesor për Shqipërinë deri në fund të vitit 2023.
- Përcaktimi i 4 vendeve si model: Për këtë funksion, vendet e mëposhtme janë zgjedhur:

- Italia (anëtare e G7, themeluese e BE, metrologji të zhvilluar, sistem shkencor metrologjik të klasifikuar, partneri më i madh tregtar i Shqipërisë)

- Austria (Me një PBB/GDP për frymë nga më të lartat në Evropë, tepër e fortë në metrologjinë ligjore, sistem të centralizuar, gjeografikisht afër Shqipërisë)

- Turqia (Ekonomi e Madhe, së fundmi i interesuar për metrologjinë, zhvillim të shpejtë kohët e fundit në metrologji, Vend Ballkanik, ngjashmëri kulturore me Shqipërinë, sistem të centralizuar)

- Sllovenia (Vend dhe ekonomi e përmasave të vogla, zhvillime të fundit në metrologji, Vend Ballkanik, sistem të klasifikuar të metrologjisë).

- Riorganizon të dhënat përkatëse mbi këto 4 vende duke përdorur të dhënat mbi Shqipëri.

- Përcakton parametrat e ndryshimit kohor për të përshtatur progresin e Shqipërisë me përvojat e kaluara të 4 vendeve të tjera.

- Përdor të dhënat e Shqipërisë në 4 vitet e fundit dhe i krahason ato me përvojat e kaluara të 4 vendeve të përzgjedhura.

- Nëse koeficienti i korrelacionit është më i lartë se 0.7, përdor Modelin e Zhvillimit (të shpjeguar në seksionin tjetër), përndryshe përdor vlerësimin më të Mirë nga Përvoja.

- Për këtë funksion, koeficienti i korrelacionit ishte 0.72. Kjo është tepër afër pasigurisë prej 20%, prandaj Modeli i Zhvillimit është përdorur.

Hapi 3: Zhvillimi i Strategjisë

Detyrat të cilat u implementuan për këtë hap janë:

Vlerësimi i Kërkesave (Fizike)

- Përdorimi i rezultateve të analizave të mësipërme
- Përdorimi i modelit të përzgjedhur më sipër
- Sigurimi vjetor i kërkesave për matjeve
- Përcaktimi i kërkesave lidhur me
- Standartet Kombëtare (Metrologji)
- Kalibrimet (Metrologji)
- Verifikimi (Metrologjia Ligjore)
- Aprovimi i tipit (Metrologjia Ligjore)

- Marrja e kërkesave në fushat e tjera nga ana e konsulentëve përkatës ose kërkesat e vlerësuara për
- Rregullat
- Mbiqyrtja Tregut, Inspektimi dhe Kontrolli
- Standardizimi
- Çertifikimi
- Akreditimi
- Për periudha 5 vjeçare për 15 vjet
- Krahasimi i kërkesave të siguruara prej konsulentëve të tjerë me kërkesa për infrastrukturën e matjes.
- Realizon ndryshime për metrologjinë nëse është e nevojshme
- Propozon sistemin e nevojshëm konform kërkesave të Organizatës Botërore të Tregtisë dhe BE.
- Vlerëson kohën e nevojshme dhe kohën në dispozicion për kalimin/tranzicionin.
- Vlerëson koston e tranzicionit/kalimit.
- Ri-analizon aftësinë e organizatave përkatëse për të thithur investime të reja lidhur me
- Ambientet fizike (godina, laboratore, sistemet IT, furnizimi me energji, kontrolli mjedisor, zhurmat, pluhuri, etj.)
- Burimet njerzore (aftësia për të pajtuar në punë njerëz kompetent, përvojën egzistuese, kapacitete për të mësuar, aftësi gjuhësore, pagesa, sistemin e promovimit, ruajtjen e stafit të trajnuar etj.)
- Zotërimi (Motivacionit, sistemit të marrjes së vendimeve, inovacionet, aftësia për të zgjidhur problemet).
- Mjedisi Operacional (prokurimi, rregulloret e pajtimit në punë, formalitetet doganore, transaksionet financiare, rregulla të tjera publike, detyrime)
- Kufizime të tjera të mundshme.
- Duke marrë parasysh fondet në dispozicion dhe aftësitë thithëse të investimeve të organizatave përkatëse, realizon modifikimet e nevojshme nëse nevojitet.
- Ri-vlerëson kohën që kërkohet dhe kohën në dispozicion për tranzicionin/kalimin.
- Ri vlerëson koston e tranzicionit/kalimit.
- Përgatit draftin e programit për një plan veprimi
- Përgatit vizionin për gjëndjen e Metrologjisë në Shqipëri në fund të çdo periudhe 5 vjeçare.
- Ri-formaton të gjithë paketën dhe finalizon Strategjinë.

iv. Modeli i Zhvillimit

Modeli i Zhvillimit bazohet në supozimet e mëposhtme:

Burimet e nevojave për infrastrukturën e matjes:

- Kërkesat ekonomike dhe sociale.
- Kërkesat rregullatore. Kjo nuk është identike me nevojat ekonomike dhe sociale. Në disa fusha egziston nevoja por matjet nuk janë sistemuar. Në disa fusha është abuzuar me kërkesat rregullatore dhe ato nuk përshtaten me nevojën.
- Kërkesat ndërkombëtare. Shqipëria po bëhet pjesë e botës së industrializuar dhe egzistojnë shumë kërkesa të forta për një partneritet të tillë, veçanërisht në fushën e lëvizjes së lirë të mallrave. Gati të gjitha kërkesat kanë lidhje me infrastrukturën e matjes/vlerësimit.
- Kostot e ndjekjes. Kur realizojmë vlerësime, duhet të sigurojmë ndjekjen e nevojshme për vlerësimin në fjalë. Një tjetër vlerësim realizohet për të siguruar ndjekjen e këtij sistemi të veçantë. Egzistojnë kur nevojitet të investohet në fusha të reja me qëllim uljen e kostove të ndjekjes në fusha të tjera. Për shembull, një institut metrologjik mund të zgjedh të investoj në një sistem parësor (me saktësinë më të lartë) edhe pse nuk egziston nevoja ekonomike, sociale apo ndërkombëtare. Megjithatë gradimi i pajisjeve dytësore/të vjetra jsh të shtetit kushton shumë dhe investimi në një sistem parësor është i justifikueshëm nga ana ekonomike.

Kufizimet për zotërimin e sistemit të nevojshëm, kur nevojitet.

- Ambientet në dispozicion. Metrologjia kërkon tre kushte kryesore për të funksionuar. Pajisje të përshtatshme, operator dhe kontroll mjedisor. Pra, godina për sistemimin e laboratoreve dhe sigurimin e kushteve mjedisore mbetet një kufizim serioz për investime.
- Personeli. Kjo mbetet një nga elementet më kritike të sistemit. Nëse personi që operon instrumentin më delikat të matjes/vlerësimit nuk është në gjëndje të kryej punën e tij ashtu siç duhet ose nuk zotëron metodat e matjes/vlerësimit, analizën e të dhënave, përgatitjen e çertifikatës, mirëmbajtjen e sistemit, atëherë matjet/vlerësimet nuk janë të vleshme.
- Burimet financiare. Përveç investimeve në sistemet kryesore, metrologjia kërkon një shumë të konsiderueshme të ardhurash rrjedhëse si për udhëtime, gradime, riparime dhe mirëmbajtje të pajisjeve të matjes/vlerësimit, harxhimeve etj. Nëse këto nuk sigurohen si duhet, metrologjia nuk mund të evoluojë.
- Zotërimi, motivimi, Kjo përfaqëson dëshirën për të kryer siç duhet dhe në kohë detyrën. Kjo mbulon të gjithë sistemin përkatës të vendim marrjes, parlamentin, qeverinë, METE, organizatat e IC dhe individët.
- Kufizimet logjistike. Këto janë çështje të formaliteteve lokale si pajtimi në punë, prokurimi, transporti, doganat, etj. Formalitetet brënda këtyre sistemeve mund të ngadalësojnë në mënyrë të konsiderueshme

zhvillimet. Përveç formalitete, organizatat financuese kanë burokracitë e tyre.

Modeli përdor burimet për nevojat si mundësues (promotor) të sistemit metrologjik dhe kufizimet si kufizues (frena) të sistemit.

Atëherë parametrat e vlerësohen për 15 vitet e ardhshme dhe investime optimale për një fushë të tillë vlerësimi janë siguruar. Më poshtë paraqitet teknika e përdorur.

Mundësuesit (promotorët)

E Nevojat Ekonomike (ndërmjet 0 dhe 5)

R Kërkesat Rregullatore (ndërmjet 0 dhe 5)

I Kërkesat për Njohje Ndërkombëtare (ndërmjet 0 dhe 5)

C Kërkesat për Ndjekje (ndërmjet 0 dhe 5)

Kufizuesit :

P Ambientet (ndërmjet 0,01 dhe 1)

S Stafit (ndërmjet 0,01 dhe 1)

F Kufizimet financiare (ndërmjet 0,01 dhe 1)

O Zotërimi/Motivimi (ndërmjet 0,01 dhe 1)

L Kufizime logjistike (ndërmjet 0,01 dhe 1)

Rezultati

G Potenciali i Rritjes

Bi Ngarkesa për mundësuesit

di Ngarkesa për kufizuesit

$G=(\beta EE+\beta RR+\beta II+\beta CC)*(\delta PP)(\delta SS)(\delta OO)(\delta LL)$ or

$G=(\beta EE+\beta RR+\beta II+\beta CC)*\alpha.P.S.O.L$

Ku α përfaqëson ngarkesën e kombinuar për frenuesit

Për këtë projekt, nuk kishte kohë të mjaftueshme për të matur ose përlllogaritur apo vlerësuar koeficientët e ngarkesës ndaj i konsiderojmë të gjitha si 1. Atëherë kemi:

$$G=(E+R+I+C).P.S.O.L$$

Këtu mundësuesit varen si nga fusha ematjes/vlerësimit ashtu edhe nga viti por kufizuesit varen vetëm nga viti.

Kështu për çdo fushë vlerësimi/matje (m) ose për një vit të dhënë (v) kemi

$$G_{m,y}=(E_{m,y}+R_{m,y}+I_{m,y}+C_{m,y}).(P.S.O.L)_y$$

Më vonë përdoret një metodë përsëritëse me dy etapa.

Etapa e Parë

1. “P,S,O,L” vlerësohet për çdo vit gjatë projektit. Kjo sasi gjithashtu quhet “Kapaciteti Thithës për Investim”.

2. “I” vlerësohet për çdo vit dhe për çdo fushë matje/vlerësimi (tabelat e CIPM/MRA janë përdorur për këtë qëllim.)

3. “E” vlerësohet për çdo fushë matje/vlerësimi dhe për çdo vit duke përdorur një nga dy metodat:

a. Metoda avancuar: Nëse vendi zotëron një Plan Zhvillimi Industrial, atëherë ky plan përdoret për të vlerësuar kërkesat ekonomike duke përdorur 1820 lloje produktesh dhe 116 lloje matjesh/vlerësimesh. Për Shqipërinë nuk egziston një Plan Zhvillimi Industrial, kështu që kjo metodë mund të mos përdoret.

b. Metoda e kundërt: Nëse vendi nuk zotëron një PZHI, atëherë për secilin nga 116 llojet e matjeve/vlerësimeve nevoja e vitit të parë vlerësohet duke përdorur 260 aktivitete ekonomike globale në 10 kategori SITC (Standard International Trade) Classification/Klasifikimi Standart Ndërkombëtar i Tregtisë). Viti i fillimit për këtë model merret viti 2001 pasi zotërojmë statistika të besueshme të tregtisë me jashtë që nga ai vit. Referoju Shtojcës XIII për treguesit ekonomik të përdorur. Më vonë, për çdo vit, norma e vlerësuar e GDP përdoret rritjen ekonomike në fushën e veçantë të matjes/vlerësimit. Një koeficient ngarkese përdoret për të përshtatur rritjen aktuale në lidhje me rritjen e GDP. Rastet ekstreme përbëjnë vlerësime magnetike me koeficient 0.05 dhe matje dimensionale me koeficient 3,6. Për këtë funksion, pragu për investim është përcaktuar 5. Kur nevoja totale përbën më shumë se 5 (nga një maksimum prej 20) investimi justifikohet.

4. “R” vlerësohet për çdo fushë matje në mënyrë vjetore duke përdorur “E” e vlerësuar. Për vende me sistem rregullator të fortë, (ish vendet komuniste, vendet e Evropës Veriore dhe disa vende të Evropës Qëndrore) përdoret një koeficient ndërmjet 0 dhe 1,4 në varësi të fushës së vlerësimit. 0 përfaqëson mungesën totale të sistemit dhe 1,4 përfaqëson afërsisht 40% të tregut të sistemuar për atë zonë të veçantë matje/vlerësimi. Shifrat korresponduese mbeten 0-0,8 për shtetet e Evropës Qëndrore, 0-1,1 për pjesën tjetër të Evropës dhe 0-0,6 pjesën

tjetër të botës me shumë përjashtime.

5. Atëherë Gm,y vlerësohet duke injoruar Cm,y. Pasi përcaktohet Gm,y, atëherë Cm,y përcaktohet midis 0,5% dhe 1/3 të nevojës së vlerësimit në varësi të tipit të vlerësimit. Cm,y mund të jetë ndërmjet 0 dhe 5.

Etapa e dytë

6. Atëherë Cm,y shtohet në formulë dhe Gm,y ri-vlerësohet duke dhënë rezultatin përfundimtar.

7. Atëherë përcaktohet sistemi i matjes/vlerësimit dhe pajisja laboratorike e nevojshme për çdo Gm,y. Nëse Gm,y rezulton më e madhe se 5, atëherë investimi është i justifikuar.

Tabelat, koeficientët universal, matricat korrelative të tërthorta dhe programet/software e nevojshme të cilët përbëjnë Modelin e Zhvillimit janë përpiluar nga ana e Autorit dhe konsiderohen të dhëna të patentuara. Megjithatë, të dhënat ekonomike të përdorura si inpute për Modelin e Zhvillimit jepen në Shtojcën G dhe përmbledhja e rezultateve jepet në Shtojcë D.

Shtojca D Rezultatet e Modelit të Zhvillimit për Metrologjinë

a. Vlerësimi i Kërkesave

Ashtu siç u diskutua në Shtojcën C (Kuadri i Strategjisë), egzistojnë katër grupe kërkesash. Dy prej tyre (Kërkesa ekonomike dhe Ndërkombëtare) përbëhen nga parametra të pamvarur dhe dy kërkesat e mbetura (Rregullat dhe Ndjekja) mund të përfitohen me anë të një formule.

Kërkesat Ndërkombëtare janë universale dhe varësia në një vend të vetëm është tepër e dobët krahasuar me të tjerët. Në përgjithësi, kërkesat kategorizohen nga madhësia e ekonomive dhe zhvillimi industrial. Pra, sfida më kryesore mbetet përcaktimi i Kërkesave Ekonomike.

Metoda e përdorur përshkruhet në shtojcën e mëparshme. Në këtë kapitull, rezultatet do të paraqiten në tre kategori:

- Kostot e Investimit (pajisje, programe/software dhe punime civile)
- Kërkesat e Personelit (për sa i përket numrit total të personelit)
- Kostot e Transferimit të Njohurive Teknike/Know-how (për sa i përket trajnimeve dhe consulencave)

